



Energy Regulatory Office
Zyra e Rregulatorit per Energji
Regulatorni Ured za Energiju

Rruga Hamdi Mramori No 1, Prishtinë - Kosovë
Tel: +381 (0)38 247 615 lok. 101, Fax: +381 (0) 38 247 620
E-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

RAPORTI VJETOR 2005

Prill 2006

*Nuk ka mundësi më të mirë të paraqitur në këtë jetë se sa rasti që të punosh
shumë një punë që ia vlen të bëhet ...*

(Presidenti i SHBA-së Theodore Roosevelt)

PARATHËNIE NGA KRYESUESI

Në vitin tim të dytë si kryesues jam krenarë të raportoj që ZRRE-ja ka bërë edhe një përmbushje të shkëlqyer të detyrave dhe i është afruar për një hap më afër përmbushjes së misionit të saj që të bëhet faktori kyç për të udhëhequr në Kosovë, në themelimin e një tregu efikas të energjisë të bazuar në parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë.

Viti 2005 ka qenë një vit i shënuar i arritjeve të mëdha për ZRRE-në dhe këto zhvillime të mëdha përfshijnë:

- Kompletimin e rekrutimit të stafit (24), përderisa aktivitetet kryesore të trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve janë duke vazhduar
- Përgatitja e Biznes Planit 5 vjeçar
- Përgatitja e Modelit të Tregut dhe e Rregullave të Tregut, të cilat aktualisht janë në konsultim publik
- Miratimi i Rregullës së Çmimeve dhe Metodologjisë së Tarifave që bëjnë të mundur fillimin e Shqyrtimit tonë të parë të çmimeve për sektorin e energjisë elektrike në vitin 2006
- Nxjerrja e një numri të Rregullave të Legjislacionit Sekondar që kompletton Kornizën tonë Rregullative
- Kompletimi i suksesshëm i Shqyrtimit të Çmimeve për Ngrohjen Qendrore për sezonin 2005-06

Këto ishin zhvillimet kryesore. Në të gjitha pjesët e ZRRE-së çdo ditë ka pasur të arritur shumë të rëndësishme, prej ofrimit të shërbimeve të mira dhe përmirësimit të vlerës për konsumatorët e energjisë deri tek përfaqësimi i Kosovës në forume të ndryshme ndërkombëtare.

Qartësia e objektives tonë kryesore – sigurim i një tregu transparent dhe konkurrent të energjisë – do të thotë se kemi një qëllim të qartë dhe përqendrim të fuqishëm në atë që duhet bërë.

Do të doja të shpreh falënderimet e mia më të mira për të gjithë kolegët e mi për punën dhe përkushtimin e tyre të palëkundur dhe për rezultatet tashmë të arritura. Ekspertiza e tyre, profesionalizmi dhe përkushtimi janë një garanci se do të përmbushim të gjitha qëllimet sfiduese që janë para nesh.



Nick F Frydas

PËRMBAJTJA

	<u>Page</u>
PARATHËNIA NGA KRYESUESI	2
PËRMBAJTJA	3
LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE	5
LISTA E SHKURTESAVE	6
KAPITULLI 1 SHQYRTIMI I ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E ENER GjISË ELEKTRIKE GJATË 2005	7
1.1 MIHJA E LINJITIT	7
1.2 GJENERIMI I ENER GjISË ELEKTRIKE	7
1.3 TRANSMISIONI DHE DISTRIBUCIONI	8
1.4 KËRKESA PËR ENER GjI ELEKTRIKE	9
1.5 IMPORTI DHE EKSPORTI I ENER GjISË ELEKTRIKE	12
1.6 PLANI I KEK-ut PËR RIMËKËMBJE FINANCIARE	14
1.7 INKORPORATIZIMI I KEK-ut	14
1.8 STRATEGJIA E ENER GjISË SË KOSOVËS PËR 2005-2015	15
KAPITULLI 2 PROPOZIMI PËR MODEL TË TREGUT TË ENER GjISË ELEKTRIKE	16
KAPITULLI 3 METODOLOGJIA PËR TARIFAT E ENER GjISË ELEKTRIKE DHE SHQYRTIMI I ÇMIMEVE	20
3.1 RREGULLA PËR RREGULLI MBI PARIMET E PËRLLOGARITJES SË TARIFAVE NË SEKTORIN E ENER GjISË ELEKTRIKE (RREGULLI MBI ÇMIM-VËNIEN)	20
3.2 METODOLOGJIA E TARIFAVE	21
KAPITULLI 4 LEGJISLACIONI SEKON DAR – MBROJTJA E KONSUMATORËVE	27
4.1 LEGJISLACIONI SEKON DAR	27
4.2 MBROJTJA E KONSUMATORËVE	30
KAPITULLI 5 PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMEVE TË ARD HSHME NË GJENERIMIN E ENER GjISË ELEKTRIKE	31
5.1 HISTORIKU	31
5.2 STUDIMET E PARA-FIZIBILITETIT RRETH REHABILITIMIT TË TC KOSOVA A	31
5.3 KAPACITETI I RI I GJENERIMIT TERMOCENTRALI KOSOVA C	33
5.4 PERSPEKTIVA E HC “ZHUR”- PRIZREN	36
5.5 CENTRALET E VOGLA ENER GjETIKE	36

KAPITULLI 6	ZHVILLIMET RAJONALE DHE MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE	37
	6.1 PREZANTIMI I PROCESIT TË ATHINËS – TRAKTATI I KEEJL	37
	6.2 MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE	39
KAPITULLI 7	PASQYRA E AKTIVITETEVE TJERA TË ZRRE	41
	7.1 AKTIVITETET KRYESORE TË ZRRE MË 2005	41
	7.2 VIZITAT DHE KONFERENCAT	41
KAPITULLI 8	NGROHJA QËNDRORE	43
	8.1 PËRSHKRIMI I SHKURTËR I SEKTORIT TË NGROHJES QËNDRORE NË KOSOVË	43
	8.2 KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR SHQYRTIMIN E ÇMIMEVE TË NGROHJES QËNDRORE	45
	8.3 SHQYRTIMI I ÇMIMEVE PËR SEZONIN E NGROHJES QËNDRORE 2005-2006	46
	8.4 VAZHDIMI I IMPLEMENTIMIT TË TARIFAVE PËR NGROHJEN QËNDRORE PËR SEZONIN 2005-2006	48
KAPITULLI 9	PASQYRA FINANCIARE 2005 – PLANI I BIZNESIT – PROJEKT DOKUMENTI	50
	9.1 PASQYRA FINANCIARE 2005	50
	9.2 PLANI I BIZNESIT	52
	9.3 PROJEKT DOKUMENTI	53

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

		<u>Faqe</u>
Tab. 1.1	Prodhimi dhe konsumimi i linjtit	7
Tab. 1.2	Kapaciteti nominal dhe operativ i njësive prodhuese në 2005	8
Fig. 1.1	Kapaciteti nominal dhe operativ i njësive prodhuese në 2005	8
Tab. 1.3	Karakteristikat e sistemit të transmisionit & distribucionit	9
Tab. 1.4	Balanci Elektroenergjetikë: i parashikuar 2005 – i realizuar 2005 – i parashikuar 2006	10
Tab. 1.5	Net Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve	10
Fig. 1.2	Prodhimi dhe Importi në 2005	10
Fig. 1.3	Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve, Humbjet dhe Eksporti 2005	11
Tab. 1.6	Shuma e përgjithshme e energjisë elektrike të faturuar & humbjet	11
Tab. 1.7	Niveli mujor i inkasimit	11
Tab. 1.8	Numri i konsumatorëve në 2005	12
Tab. 1.9	Shënimet historike të importit të energjisë elektrike (2000-2005)	12
Fig. 1.4	Çmimi & Sasia e importit të energjisë elektrike (2000-2005)	13
Tab. 1.10	Importi & eksporti mujor më 2005	13
Fig. 1.5	Çmimi & Sasia e importit të energjisë elektrike në 2005	14
Fig. 2.1	Modeli i Tregut – Net Pool	18
Fig. 3.1	Tarifat e rregulluara dhe të parregulluara	22
Fig. 3.2	Taksat për kyçje të thellë dhe të cekët	23
Fig. 3.3	Çmimet tavan (normat e bazuara në performansë) të ilustruara	24
Fig. 3.4	Ilustrimi i Bllok tarifës rritëse	26
Tab. 5.1	Rezultatet e studimit të fizibilitetit për rehabilitimin e njësive të TC “Kosova A”	32
Tab. 5.2	Kostoja e operimit të Centralit	35
Tab. 5.3	Përfitimet e drejtpërdrejta të ekonomisë Kosovare gjatë një tremujori të operimit të një centrali prej 2,000 MW	35
Tab. 8.1	Karakteristikat teknike të Sistemeve të Ngrohjes Qendrore	44
Tab. 8.2	Shkalla e inkasimit në Ndërmarrjet e NQ në Kosovë për sezonin e ngrohjes 2004/2005	45
Tab. 8.3	Tarifat për Ndërmarrjen e NQ “TERMOKOS” për sezonin e ngrohjes 2005/2006	47
Tab. 8.4	Tabela e përmbledhur e tarifave për konsumatorët e njehsuar dhe ata të pa njehsuar – NQ sezoni 2005-2006 për katër KNQ në Kosovë	48
Tab. 9.1	Pasqyra e Burimeve dhe Aplikimi i Fondeve (në €)	50
Tab. 9.2	Profiti & Humbjet viti 2007 sipas Planit të Biznesit	53

LISTA E SHKURTESAVE

UA	Udhëzim Administrativ (UNMIK)
IA	Instruksion Administrativ (UNMIK)
BMZ	Bundesministerium für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung (Germany)
TNK	Tregtim Ndërkufitar
KREE	Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji
AKZN	Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar
NQ	Ngrohje Qendrore
CNQ	Kompani e Ngrohjes Qendrore
NNQ	Ndërmarrje e Ngrohjes Qendrore
SD	Sistemi i Distribucionit
OSD	Operator i Sistemit të Distribucionit
ZPSSP	Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (të KB)
AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
BERZ	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
KEEJL	Komiteti i Energjisë për Evropën Juglindore
BEI	Banka Evropiane për Investime
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
PATSE	Projekti për Asistencë Teknike për Sektorin e Energjisë (BB)
BE	Bashkësia Evropiane
HC	Hidro Central
ANE	Agjencioni Ndërkombëtar për Energji
PPE	Prodhues i Pavarur i Energjisë
OPSTT	Operator i Pavarur i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Gjermani)
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
kW	Kilo Watt
kWh	Kilo Watt orë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (IPVQ)
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave (IPVQ)
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (IPVQ)
OT	Operator i Tregut
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MW	Mega Watt
MWh	Mega Watt orë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisë
NP	Ndërmarrje Publike
MBE	Marrëveshje për Blerje të Energjisë
BRA	Baza Rregullative për Asete
TRE	Tregu Rajonal për Energji
EJL	Evropa Juglindore
OSTEJL	Operatorët e Sistemit të Transmisionit për Evropën Juglindore
AT	Asistencë Teknike
PP	Përshkrimi i Punës
QPT	Qasja e Palës së Tretë
TC	Termocentral
ST	Sistemi i Transmisionit
OSTT	Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
OST	Operatorë i Sistemit të Transmisionit
ZKBSP	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo
USAID	United States Agency for International Development
BB	Banka Botërore

KAPITULLI 1: SHQYRTIMI I ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË 2005

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë vazhdon të jetë i dominuar nga një kompani vertikalisht e integruar, KEK-u. Kjo është një Ndërmarrje në Pronësi Publike, mjetet e së cilës janë nën mbikëqyrjen (besimin) e AKM-së, përgjegjësia e së cilës është mes tjerash që të ruaj ose përmirësoj vlerën, qëndrueshmërinë dhe menaxhimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore apo publike në Kosovë. KEK-u ka 10 divizione me një numër të përgjithshëm prej 8,375 të punësuarve. Pesë bizneset e kryesore janë: minierat e linjtit, gjenerimi i energjisë elektrike, transmissioni & dispeçingu, distribucioni dhe furnizimi. Divizioni i mihjes ka 44% të numrit të përgjithshëm të punësuarve në KEK, ndërsa gjenerimi dhe distribucioni kanë 19% gjegjësisht 13%. Zhvillim i rëndësishëm në vitin 2005 është ndërmarrja e projektit të inkomporimit të KEK-ut që pritet të kompletohet gjatë vitit 2006. Projekti final i inkomporimit do të përcaktojë dy kompani të ndara: e para, KEK-u me funksionet e mihjes, gjenerimit, distribucionit dhe furnizimit; dhe e dyta, OPSTT (ITSMO), me pronësi të aseteve të transmissioinit dhe përgjegjësi për operimin e sistemit & tregut (në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Marrëveshjes me KEEJL - ECSEE). Është planifikuar që mjetet dhe përgjegjësitë të transferohen nga KEK-u i vjetër në holdingun e ri të krijuar KEK hold Co., dhe KEK New Co, ku e dyta do të ketë 6 divizione të ndara. Kompania e re ITSMO do të themelohet si nëndërmarrje vartëse, në pronësi të plotë nga KEK New Co, për një periudhë deri në vitin 2008, duke pasur detyrë transmissioinit e energjisë elektrike dhe Operimin e Tregut.

1.1 MIHJA E LINJITIT

Mihja e linjtit është 98% e varur nga prodhimi i energjisë elektrike në KEK, ndërsa energjia elektrike e prodhuar nga KEK-u është 100% e varur nga furnizimi me thëngjill. Kjo varësi reciproke tregon se resursi kryesor i energjisë për Kosovën, linjiti, është i pazëvendësueshëm. Resurset kryesore të linjtit gjinden në dy basene të mëdha, të emëruara “Kosova” dhe “Dukagjini” me rezerva të ekspluatueshme të kualitetit të mirë, me përmbajtje të ulët të sulfurit dhe koncentrim të mirë të gëlqeres. Rezervat e vlerësuara të linjtit arrijnë deri në 14 bilion tonelata. Momentalisht në operim janë dy mihje të hapura të linjtit (Bardh dhe Mirash), që furnizojnë me 6.5 milion tonelata në vit njësitë gjeneruese të energjisë elektrike në KEK. Vlerësimi i fundit jep sinjale se këto miniera do të zbrazen tërësisht deri në vitin 2012, me një rënie të konsiderueshme të nxjerrjes që nga viti 2009. Kjo çështje alarmuese e thekson nevojën për investime në minierë të re linjiti që duhet të vihet në funksion fillimisht më 2009. KEK-ut i është dhënë një licencë për hulumtim për hapje të një miniere të re në “SW Sibovc” por ekzistojnë vështirësi të konsiderueshme në sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për investimeve.

Tabela 1.1 Prodhimi dhe konsumimi i linjtit

Prodhimi & Konsumi i Lignitit (2005)	Ton
Gjithsej prodhimi i lignitit	6 536 759
Gjithsej konsumi i lignitit	5 796 658

1.2 GJENERIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Funksioni i KEK-ut për gjenerimin e energjisë elektrike kryhet nga dy termocentralet: Kosova A (5 njësite) dhe Kosova B (2 njësite) prodhimi i së cilave bazohet në djegjen e linjtit. Kapaciteti i përgjithshëm i centraleve është 1,478 MW, që do të ishte e mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e tanishme për energji elektrike në Kosovë. Megjithatë, për shkak të vjetërsisë, mirëmbajtjes dhe funksionimit joadekuat gjatë viteve para dhe pas luftës, si dhe për shkak të dëmtimeve nga lufta, besueshmëria dhe kapaciteti i përgjithshëm i gjenerimit të këtyre centraleve është dëmtuar seriozisht. Kështu, veçanërisht Kosova A demonstroi aftësi të ulët gjeneruese në rast se nuk rehabilitohet. I vetmi central i rëndësishëm jashtë KEK-ut është Hidrocentrali Gazivoda/Ujmani (2 njësite me nga


17.5 MW), të administruara nga kompania e ujit (Hidro-sistemi Ibër-Lepenci). Në nëntor të vitit 2005, një hidrocentral i ri “Lumëbardhi” filloi punën. Ky central gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, rreth 15 kilometra larg qytetit të Deçanit. Ai është në pronësi të KEK-ut ndërsa menaxhohet nga Triangle General Contractors Inc. (TGC) sipas një kontrate 20-vjeçare për qiradhënie dhe sipas një marrëveshje për blerjen e energjisë (PPA) me KEK-un (tarifa “feed in”). Në këtë projekt janë investuar rreth 6 milion € për renovim dhe ngritje të kapacitetit prej 7.35 MW në 8.3 MW. Deri në fund të vitit 2005 ky hidrocentral ka prodhuar 1.9 GWh. Vlen të theksohet se ky është projekti i parë privat në sektorin e energjisë së Kosovës që financohet me të drejtë të përvetësimit, në rast të dështimit të kompensimit të kredisë.

Tabela 1.2 Kapaciteti nominal dhe operativ i njësive prodhuese në 2005

Termocentralet me Ligniti	Viti i ndërtimit	Kapaciteti i Dizajnuar	Kapaciteti Operues	Faktori i shfrytëzimit (dizajnuar)	Faktori i shfrytëzimit (operues)
<i>Njësia</i>	<i>year</i>	<i>[MW]</i>	<i>[MW]</i>	<i>%</i>	<i>%</i>
A1	1962	65	25	13.67%	35.55%
A2	1964	125	-	-	-
A3	1970	200	-	-	-
A4	1971	200	-	-	-
A5	1975	210	110	36.29%	69.28%
TC Kosova A		800	135	10.64%	63.04%
B1	1983	339	285	54.60%	64.94%
B2	1984	339	285	66.60%	79.22%
TC Kosova B		678	570	60.60%	72.08%
U1	1981	17.5	17.5	-	-
U2	1981	17.5	17.5	-	-
HC Ujmani		35	35	36.39%	36.39%
Gjithsej		1 513	740	33.62%	68.74%

Shënim: Faktorët e Ngarkesës të kapaciteteve të parapara dhe operative janë kalkuluar në bazë të bruto prodhimit të centraleve

Figura 1.1 Kapaciteti nominal dhe operativ i njësive prodhuese në 2005



1.3 TRANSMISIONI DHE DISTRIBUCIONI

Sistemi i Transmisionit (ST) në Kosovë përbëhet nga asetet e rrjetit në nivelet e tensionit prej 400, 220 dhe 110 kV, derisa sistemi i distribucionit (SD) përbëhet nga asetet e rrjetit prej 35, 10 & 0.4 kV. ST është pjesë integrale e ST-së të ndërlidhura regjionale dhe është e ndërlidhur me të gjitha sistemet në fqinjësi në nivelin 400 kV, përveç me Shqipërinë (vetëm në 220 kV). Një linje e re ndërlidhëse

prej 400 kV me Shqipërinë konsiderohet vitale për zbatimin e shkëmbimeve të konsiderueshme të energjisë elektrike në periudhat afat-mesëm dhe afat-gjatë ndërmjet sistemit të Kosovës që është i bazuar në termocentrale linjit djegëse, dhe sistemit të Shqipërisë të bazuar në hidrocentrale. Gjatësia e përgjithshme e linjes 400 kV është 239 kilometra, me pjesën që kalon nëpër territorin e Kosovës prej 85.5 kilometra gjatësi dhe kosto të përgjithshme prej 39.3 milion €. Ndërtimi i linjës është paraparë të filloi në vitin 2008 dhe të përfundojë në vitin 2010.

Sistemi i distribucionit KEK është i përhapur në shtatë qendrat e Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, që furnizon 331,844 konsumatorë. Gjatë vitit 2005 KEK-u ka identifikuar rreth 103,026 konsumatorë të ashtuquajtur pasivë. KEK-u është në proces të spastrimit dhe të rishikimit që do të ndodhë gjatë vitit 2006. Kjo mund të rezultojë me 50,000 konsumatorë shtesë. Në këtë vlerësim nuk janë marrë parasysh konsumatorët e enklavave serbe. Së fundi, parashikohet që numri i përgjithshëm i konsumatorëve në jetë mbi 400,000.

Për shumë vite Sistemet e Transmisionit dhe Distribucionit në Kosovë janë në pozitë të palakmueshme në saje të mungesës së investimeve dhe mirëmbajtjes së duhur të infrastrukturës. Aktualisht sistemet nuk i plotësojnë një numër të standardeve teknike. Për shembull kriteri i besueshmërisë n-1 nuk mund të përmbushet dhe kualiteti i tensionit është më i ulët se që kërkohet. Standardet e sigurisë në rrjetin e distribucionit posaçërisht në pikat e kyçjes së konsumatorëve janë nën praktikën e kërkuara ndërkombëtare. Për këtë arsye Plani i KEK-ut për Rimëkëmbje Financiare bazohet në studime të kryera që parashohin investim të kapitalit në rrjetet e transmisionit dhe distribucionit në shumë prej 395 milion € deri në vitin 2010.

Tabela 1.3 Karakteristikat e sistemit të transmisionit & distribucionit

ST & SD	Njësia	Sistemi i Transmisionit			Sistemi i Distribucionit			
Niveli i Tensionit	kV	400	220	110	35	10	-	-
Gjatsia e linjave	km	183	354	625	639.5	3971	-	-
Gjatsia e kablllove	km	-	-	-	10.5	172	-	-
Niveli i Transformimit	kV	400/220	220/110	220/35(10)	110/35	110/10	35/10	35/6
Kapaciteti i Transformimit	MVA	1200	1000	400	788	378	813.7	98

Shënim: Shënimet e Distribucionit të KEK-ut rreth transformimit të 10/0.4 kV dhe gjatësisë së rrjetit 0.4 kV nuk janë konsoliduar deri më tani.

1.4 KËRKESA PËR ENERGJI ELEKTRIKE

Periudha 2000-2005 në Kosovë, është karakterizuar me rritje substanciale të kërkesës për energji elektrike. Rritja mesatare vjetore është rreth 8%, derisa rritja prej 2004-2005 ka arritur madje 10%. Kërkesa e përgjithshme për energji, e ngarkuar në sistem për vitin 2005 ishte rreth 4.5 TWh me një pik gjatë dimrit që arrinte 898 MW, edhe pse kërkesa për energji dhe piku janë regjistruar në regjim të reduktimeve. Kjo rritje nuk pasqyron normën e rritjes së zhvillimit ekonomik dhe në rast të Kosovës kjo mund të atribuohet pagesës shumë të ulët të faturave për energji elektrike dhe mekanizmeve të pamjaftueshëm detyruese nga kompanitë publike për inkasimin e të hollave, që fatkeqësisht po krijojnë ambient për rritje të pakontrolluar të konsumit të energjisë elektrike. Niveli i rritjes së kërkesës për energji elektrike mund të jetë shumë më i madh, nëse marrim parasysh rritjen potenciale të kërkesës nga industria e cila momentalisht merr pjesë vetëm me një përqindje të vogël të shumës së përgjithshme të konsumit, mirëpo shumica e lokacioneve industriale janë në procesin e privatizimit dhe konsiderohet që konsumi i tyre do të rritet pasi që ato të vihen sërish në funksion. Regjim i reduktimeve është aplikuar gjatë tërë vitit 2005. Gjatë dimrit është aplikuar i ashtuquajtur regjim 4:2 (4 orë me; 2 orë pa rrymë), ndërkohë që ka pasur edhe raste kur janë aplikuar regjime të pakëndshme (3:3) kur temperaturat kanë qenë shumë të ulëta dhe kur importi i energjisë elektrike nuk ishte i mundur. Gjatë verës regjimi ka qenë 5:1 dhe 24:0 në rastet kur kërkesa ishte e ulët, posaçërisht gjatë natës.

Fakti që vetëm 52% e energjisë elektrike (në kWh) që është dhënë në sistem faturohet, dhe prej së cilës vetëm 66.6% inkasohet në aspektin e të hollave, nuk gjeneron fondet e nevojshme që kërkohen për të investuar në kapacitetet e energjisë (gjenerimi dhe rrjeti).

Tabela 1.4 Bilanci Elektroenergjetikë: i parashikimi 2005 – i realizuar 2005 – i parashikuar 2006

Bilanci Elektroenergjetik i KEK-ut	i parashikuar 2005	i realizuar 2005	i parashikuar 2006
<i>Prodhimi nëpë njësi</i>	<i>GWh</i>	<i>GWh</i>	<i>GWh</i>
A1	119.9	77.8	0.0
A3	0.0	0.0	430.6
A4	0.0	0.0	0.0
A5	667.7	667.6	348.0
TC Kosova A	787.6	745.5	778.6
B1	1 676.9	1 621.3	1 772.1
B2	1 813.7	1 977.9	1 932.6
TC Kosova B	3 490.6	3 599.2	3 704.7
HC Ujmani	79.2	111.6	88.0
Importi	399.9	490.6	685.6
Gjithsej energjia në disponim	4 757.3	4 946.9	5 256.9
<i>Konsumi</i>	<i>GWh</i>	<i>GWh</i>	<i>GWh</i>
Konsumi vetanak i TC	403.6	457.2	420.2
Konsumatorët Direkt & Intern	413.0	97.2	359.9
Humbjet në Transmision	129.1	280.6	138.0
Exporti	87.3	226.0	210.7
Humbjet në Distribucion	1 101.6	1 875.0	1 507.3
Net Distribucioni	2 622.7	2 010.9	2 620.2
Gjithsej kërkesa	4 757.3	4 946.9	5 256.3

Në kolonën qendrore (e verdhë) janë të dhënat për prodhimin e realizuar, importin, konsumin dhe eksportin. Mesatarja e konsumit vetjak nga centralet është rreth 10.3 %.

Tabela 1.5 Net Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve

Konsumi në 2005	GWh
Industrial	151.3
Komercial & Publik	410.9
Amvisni	1 447.9
Gjithsej Net Distribucioni	2 010.1

Figura 1.2. Prodhimi dhe importi në 2005




Figura 1.3 Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve, Humbjet dhe Eksporti në 2005




Tabela 1.6 Shuma e përgjithshme e energjisë elektrike të faturuar & humbjet

Energjia Elektrike e faturuar në 2005	GWh	%
Energjia Elektrike e dhënë në sistem	4 489.7	100.00%
Humbjet në Transmision	280.6	6.25%
Humbjet në Distribucion (teknike & komerciale)	1 875.0	41.76%
Energjia e Faturuar në të gjitha kategorit	2 334.0	51.99%

Shuma e përgjithshme e rrymës së faturuar në 2005 është 2,334 GWh, që përbëhet nga net konsumi prej 2,010 GWh (konsumatorët e distribucionit si është theksuar në Tabelën 1.7), konsumit prej 97.7 GWh nga konsumatorët e drejtpërdrejtë & të brendshëm dhe nga eksporti prej 226 GWh.

Tabela 1.7 Niveli mujor i inkasimit

Norma mujore e faturuar & inkasuar	Faturuar		Inkasuar (Paguar)	
	m€		m€	%
Janar	13.4		5.6	42.0%
Shkurt	13.5		6.6	48.6%
Mars	12.8		8.0	62.4%
Prill	9.5		8.4	88.5%
Maj	9.0		7.5	83.6%
Qershor	8.5		5.8	68.5%
Korrik	8.1		6.0	74.0%
Gusht	7.9		5.9	74.5%
Shtator	8.3		6.7	81.5%
Tetor	10.6		5.8	54.6%
Nëntor	11.4		7.1	61.8%
Dhjetor	12.0		9.8	81.7%
Gjithsej	124.9		83.1	66.6%

Tabela 1.8 Numri i konsumatorëve në 2005

Kategoritë	Nr. i Konsumatorëve
220 kV	1
110 kV	2
35 kV	12
10 kV	224
0.4 kV I	730
0.4 kV II - Një tarifor	23 559
0.4 kV II - Dy tarifor	19 458
Amvisri - Një tarifor	219 357
Amvisri - Dy tarifor	57 417
Me paushall	10 733
Ndriqimi publik	354
Gjithsej Konsumatorë	331 847

1.5 IMPORTI DHE EKSPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE


Në saje të rritjes së shpejtë të kërkesës dhe mungesës së brendshme të kapaciteteve operuese, KEK-u ka vazhduar që të importojë sasi të konsiderueshme të rrymës për të mbajtur regjimin e furnizimit prej 4:2 dhe/ose 5:1. Historikisht, KEK-u ka reduktuar sasinë e rrymës së importuar por mesatarja e ponderuar e çmimit të importit është rritur për 20.7 %. Gjatë viti 2005 KEK-u ka importuar 490.6 GWh, të kontraktuar (71.8 %) dhe si shkëmbim (28.8%). Koeficienti mesatar për shkëmbim në vitin 2005 ishte 1.3, që do të thotë se për çdo MWh që KEK-u ka importuar, ai duhet të japë 1.3 MWh si shkëmbim. Shumica e energjisë së importuar është energji e moduluar (prej 07:00 – 23:00) dhe emergjente në rastet kur është kërkuar, me një çmim që ndryshon prej €38/MWh deri në €63/MWh. Në 2005 KEK-u ka eksportuar 225.9 GWh, të kontraktuar (18.0%) dhe si shkëmbim (82.0%). Sasia e kontraktuar është e karakterizuar nga rryma jo kualitative (tepricat gjatë natës dhe/ose në kohën e shfrytëzimit jashtë orëve të pikut) që rezulton me çmime shumë të ulëta.

Tabela 1.9 Shënimet historike të importit të energjisë elektrike (2000-2005)

Importi i KEK-ut	Sasia	Çmimi	Vlera
Viti	MWh	(\$)/€MWh	(\$)/€
2000*	778 870	30.43	23 701 412
2001*	921 485	29.60	27 276 960
2002*	627 265	32.67	20 491 605
2003	314 794	44.53	14 016 421
2004	483 580	39.64	19 170 646
2005	349 335	47.87	16 723 315
Gjithsej shpenzuar për import prej 2000 - 2005			121 380 358

* Më 2000 - 2002 çmimet janë në Dollarë amerikanë (\$) me një kurs këmbimi prej rreth 1:1

Figura 1.4 Çmimi & Sasia e importit të energjisë elektrike (2000-2005)



Vërejtje: Më 2000 - 2002 çmimet janë në dollarë amerikanë (\$) me një kurs këmbimi prej rreth 1:1


Ndryshimet në sasinë e importit janë të lidhura me ndërprerjet në centrale dhe disponueshmërin e mjeteve financiare për import. Në fillim, sasia e importuar ishte shumë e lartë për shkak të rehabilitimit dhe zjarrit që kaploi Kosovën B, derisa importi është reduktuar posaçërisht në vitin 2003 kur tri njësitë e Kosovës A ishin në dispozicion dhe posaçërisht njësitë e Kosovës B, të cilat treguan disponueshmëri të lartë. Sasia e importit është rritur më 2004 për shkak të disponueshmërisë të ulët të njësisë të Kosovës A.

Tabela 1.10 Importi & eksporti mujor në 2005

KEK	Importi i blerë	Çmimi	Importi i këmbyer	Exporti i shitur	Çmimi	Exporti i këmbyer
2005	MWh	€/MWh	MWh	MWh	€/MWh	MWh
Janar	59 750	45.86	2 875	0	-	10 170
Shkurt	58 890	45.07	1 820	0	-	4 960
Mars	47 180	42.90	15 085	3 864	20.00	3 660
Prill	3 250	53.50	13 130	336	18.50	3 000
Maj	0	48.87	37 040	0	-	8 150
Qershor	17 220	44.23	8 580	0	-	40 830
Korrik	10 695	59.47	12 650	32 690	30.18	27 420
Gusht	21 240	58.59	12 070	0	-	17 645
Shtator	43 430	45.97	5 215	0	-	17 890
Tetor	49 300	50.81	2 380	2 820	38.83	29 970
Nëntor	33 660	50.82	2 220	980	27.30	16 790
Dhjetor	4 720	58.70	28 232	0	-	4 790
Gjithsej	349 335	47.87	141 297	40 690	29.65	185 275

Shuma e përgjithshme e të hollave të shpenzuara në import më 2005 është 16.7 milion €, pa e përfshirë sasinë e importit të shkëmbyer, që me një koeficient prej 1.3 vlerësohet të jetë rreth 39 €/MWh (përafërsisht 5.65 milion €). Njëkohësisht, vetëm 1.2 milion € janë inkasuar nga eksporti, që qartazi rezulton me një deficit në import/eksport tregtinë me energji elektrike.

Figura 1.5 Çmimi & Sasia e importit të energjisë elektrike në 2005



Vërejtje: Nuk ka pasur import të kontraktuar (blerë) në maj; çmimi është mesatarja e prillit dhe qershorit

1.6 PLANI I KEK-ut PËR RIMËKËMBJE FINANCIARE

Një projekt-version i Planit për Rimëkëmbje Financiare për KEK-un është duke u zhvilluar nga menaxhmenti i KEK-ut. Plani për Rimëkëmbje Financiare i zhvilluar për KEK-un mbulon periudhën prej 2005-2010 dhe definon parimet në të cilat ky plan është i bazuar dhe objektivat që duhet të arrihen. Është theksuar se KEK-u është në një pozitë shumë të dobët financiare duke u përballur me humbje të vazhdueshme në treg. Humbjet e akumuluarra deri më 30 qershor 2004 janë 458.8 milion €. Kjo pozitë e dobët financiare i është atribuar:

- punës së dobët në mbledhje të të hyrave;
- varësisë në centrale gjeneruese të vjetra dhe të pabesueshme (nivel i lartë i rënieve të planifikuara dhe të detyruara); dhe
- importit të energjisë elektrike të shtrenjtë për të kompensuar mungesën

Ka pasur një vlerësim të kërkesave për investim për periudhën 2005-2010, që nëse zbatohen do të kthenin KEK-un në një ndërmarrje financiarisht të shëndoshë. Investimi total i nevojshëm për të gjithë sektorët e KEK-ut për këtë periudhë është rreth 800 milion €, prej të cilave rreth 60% do të vijnë nga fondet e brendshme dhe 40% nga donacionet. Plani supozon një rritje të inkasimit të hollave të gatshme deri në 80% në 2010. ZRRE-ja e bën të qartë se ky është një projekt-version, që mbase mund t'u nënshtrohet komenteve dhe ndryshimeve të mëtejme.

1.7 INKORATIZIMI I KEK

Projekti i inkorporatizimit/ristrukturimit është iniciuar nga AER dhe AKM. Është bërë e njohur se ristrukturimi i KEK-ut duhet të jetë në përputhje me direktivat e UE-së dhe poashtu duhet të rezultoj me ndarjen e aktiviteteve që nuk kanë të bëjnë me energji dhe asetete përkatëse (nëse është ndonjë), duke i lënë ato jashtë biznes strukturës së re të energjisë.

Struktura e propozuar e inkorporatizimit ashtu si është përshkruar në hyrjen e Kapitullit 1 i nënshtrohet kërkesave nga Ligji i Energjisë në lidhje me aktivitetet e transmisionit, ashtu si rekomandon themelimin e OPSTT-së dhe KA-së nën kontroll të aksionarëve të kompanisë Transco Holding që kryen aktivitetet e OST-së dhe OT-së si një entitet ligjërish i ndarë. Në anën tjetër, pjesa e mbetur e KEK-ut të vjetër që ka si detyrë të kryej funksionet e mihjes, gjenerimit, distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike, e emëruar si SHA KEK New, është nën kontroll të KEK Holding-ut. Ristrukturimi i KEK-ut duhet të ofrojë qasje të lirë për palët e treta në të dy rrjetet, transmision dhe

distribucion, që si rezultat mos të ketë ndonjë ndikim apo kontroll në sferat e gjenerimit të energjisë, furnizimit dhe tregtimit si attribute kryesore të zhvillimit të tregut të energjisë në të ardhmen. Detyra e fundit e procesit të inkorporatizimit do të rezultojë me regjistrim të asetëve dhe detyrimeve që transferohen në kompanitë e lartpërmendura. Inkorporatizimi duhet të konsiderohet si një parakusht për funksionim të mëtejshëm komercial të kompanive të reja të themeluara.

1.8 STRATEGJIA ENERGETIKE E KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2005 – 2015

Strategjia Energetike e Kosovës është përgatitur nga MEM-i në përputhje të plotë me Ligjin mbi Energjinë dhe Programin e Qeverisë së Kosovës, si dhe përmban kornizën themelore me një orientim fleksibil duke marrë parasysh perspektivën zhvillimore dhe kohore për përmbushjen e objektivave të vet. Strategjia është hartuar duke u bazuar në studimet paraprake (ESTAP, KfW, White Paper) dhe nga përgjigjet e angazhuara prej AER-it dhe institutit të RIINVEST-it.

Qëllimet dhe aktivitetet afatgjata përfshijnë një periudhë prej 10 vjetësh, duke pasur si vizion disa fusha të rëndësishme për një periudhë kohore edhe më të gjatë. Është paraparë që brenda kësaj periudhe, Kosova do të posedojë kapacitete gjeneruese për energjinë elektrike prej të paktën 1,800 MW, duke siguruar një furnizim të qëndrueshëm për konsumatorët e vet, si dhe eksportim të 30-50% të energjisë elektrike të gjeneruar. Objektiva të tjerë të rëndësishëm janë përmirësimi i sektorit energjetik, përmes finalizimit të ristrukturimit dhe reformimit të KEK-ut, si dhe përmes rritjes së avantazheve konkurruese, duke siguruar mbledhjen e plotë të të ardhurave vjetore të energjisë së faturuar prej 2009, pasuar nga avancimi i rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes për reduktimin e humbjeve teknike dhe komerciale, duke siguruar njëkohësisht integrimin e plotë në rrjetin energjetik rajonal dhe evropian. Objektivi kyç i Strategjisë së Energjisë është të garantojë furnizim të sigurt dhe të mjaftueshëm me linjit gjatë gjithë periudhës së funksionimit të centraleve ekzistuese energetike, si dhe sigurimin e furnizimit të centraleve të reja energetike (që parashikohet të ndërtohen) me karburant. Deri tani janë identifikuar tre zona me potencial për të zhvilluar miniera të reja linjiti, prej të cilave fusha e Sibovcit është më e rëndësishmja, dhe që kanë rezerva të mjaftueshme (përafërsisht 1 miliard ton) për të furnizuar 2,000 MW të kapacitetit të instaluar brenda një periudhe prej 40 vjetësh.

Është deklaruar se pjesëmarrja e investitorëve privatë në segmente të ndryshme të industrisë së energjisë elektrike në Kosovë, është e nevojshme; është e nevojshme që kjo të përfshihet në operimet aktuale të shfrytëzimit mineral të linjtit dhe hapjen e minierave të reja. Burimet ekzistuese minerale me cilësi të mirë dhe me mundësitë për shfrytëzim me kosto të ulët, duhet të sigurojnë mbulimin e aktiviteteve të shfrytëzimit mineral, përfitim të arsyeshëm për investitorët privatë dhe nivel të përshtatshëm të të hyrave në buxhetin e Shtetit. Burimet e linjtit ofrojnë mundësi për ndërtimin e centraleve të reja energetike. Prodhuesit e rinj e të pavarur energjetikë (PPE) mund të furnizojnë tregun vendor dhe atë rajonal të Evropës Jug Lindore (EJL).

Vizioni është që sektori energjetik në Kosovë do të jetë teknologjikisht dhe financiarisht i zbatueshëm dhe do të bëhet pjesë e sistemit energjetik rajonal dhe evropian. Gjatë kësaj periudhe, sektori do të transformohet dhe do të zhvillojë varësinë ndaj fondeve buxhetore dhe subvencioneve në një sektor i cili do të kontribuojë në zbatueshmërinë e buxhetit të Kosovës; dhe prej sektorit importues në një sektor rajonal shumë të rëndësishëm eksportues.

KAPITULLI 2 PROPOZIM PËR MODELIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Shumë vende të botës kanë ndërmarrë hapa drejt reformimit të industrive të energjisë elektrike për të krijuar tregje konkurruese në mënyrë që të prezantojnë efikasitet dhe disiplinë të tregut në sektorët e tyre të mëparshëm monopolistë të energjisë. Qasja e zakonshme fillimisht fokusohet në nivelin e tregut me shumicë, ku prodhimet e centraleve gjeneruese që konkurojnë njëra me tjetrën i ofrohen një “tregu” ku shitësit me pakicë dhe subjektet tjera shërbyese të këtij produkti blejnë energji në sasi të mëdha. Kështu tregu spastrohet dhe si rezultat përfitohet një çmim i theksuar tij. Për shkak të karakteristikave unike fizike të energjisë elektrike si produkt, kryesisht jo deponimi, efekti që rrjedha komerciale nuk është domosdoshmërisht edhe rrjedha fizike e shpërndarjes, nevoja për një balancim të vazhdueshëm të sistemit, si dhe nevoja për sigurimin e shërbimeve të veçanta (shërbimet ndihmëse) për stabilitetin e sistemit; modelet e tregut të energjisë elektrike kanë dizajne të sofistikuar dhe rregulla relativisht të ndërlikuar. Një çështje me rëndësi në hartimin e një modeli të tregut është shpërndarja e të drejtave dhe përgjegjësi midis të gjithë pjesëmarrësve të atij tregut. Procesi me të cilin përcaktohen transaksionet e lejuara dhe detyrimet financiare midis palëve, menaxhohet nga Operatori i Tregut (Llogaritja dhe Spastrimi-Kliringu i Tregut), derisa roli kryesor i Operatorit të Sistemit është balancimi fizik “në kohën-reale” dhe alokimi i të drejtave për shfrytëzimit të sistemit. Prodhuesit, furnizuesit, tregtarët interkonektues dhe palët e tjera që tregtojnë energjinë elektrike, futen në treg si palë tregtuese ndërsa të drejtat dhe detyrimet e tyre janë caktuar në Rregullat e Tregut. Megjithatë, mbi të gjitha është koordinimi midis balancimit në kohën-reale dhe aktiviteteve operacionale të kryera nga operatori i sistemit dhe marrëveshjet komerciale për programimin, jobalancin, menaxhimin e kongjestionit dhe shërbimet ndihmëse, si dhe mënyrën se si janë integruar me çmimet aty për aty (spot prices) që përcaktojnë suksesin e modelit të tregut.

Sipas kërkesave të Ligjit 2004/10 “mbi Energjinë Elektrike”, Kosova duhet të zbatojë një model të tregut konkurrues në sektorin e vet të energjisë elektrike, detyrë e cila i është dhënë “Operatorit të Tregut” (OT) nga ky Ligj. OT-ja emërohet nga Qeveria, derisa sipas Ligjit, Rregullat e Tregut duhet të aprovohen nga ZRRE-ja. OT-ja duhet të funksionojë në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje e angazhuar në aktivitete të energjisë elektrike përveç transmetimit. Ky subjekt mund të jetë i njëjtë me OST-në përgjegjësitë e të cilit janë dhënë po ashtu në Ligjin mbi Energjinë Elektrike. Projekti korporativ i KEK-ut që vazhdon të jetë ende nën proces, në fakt krijon një ent të pavarur të quajtur ITSMO i cili përfshin të dy aktivitetet me llogari të ndara midis tyre. Ndërkohë, meqenëse gjatë vitit 2005 nuk është caktuar OT, ZRRE-ja me miratimin e Qeverisë, ka marrë përsipër detyrimin për të zhvilluar një Model Tregu dhe rregullat e tij (Kodin e Tregtisë ose Rregullat e Tregut – legjislacioni dytësor), pasi promovimi i krijimit të një tregu konkurrues është mandat i ZRRE-së. Zhvillimi i një Modeli Tregu të plotë dhe të zbatueshëm që momentalisht po i nënshtrohet konsultimit publik, është një nga dy detyrat kryesore që janë ndërmarrë me sukses nga ZRRE-ja gjatë vitit 2005 (detyrë tjetër me rëndësi është zhvillimi i Metodologjisë së plotë të Tarifave).

Gjatë zhvillimit të Modelit të Tregut dhe rregullave të tij, ZRRE-ja ka marrë në shqyrtim edhe parakushtet për një treg të suksesshëm si dhe nevojat dhe përparësitë e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë. Elementet thelbësore që sigurojnë parakushtet e nevojshme për zhvillimin e një tregu konkurrues dhe likuid, janë: situata furnizuese që tejkalon kërkesën; korniza për Qasjen jo diskriminuese të Palës së Tretë (QPT-TPA) në rrjete; reagimin e gjenerimit dhe ngarkesës ndaj sinjaleve të çmimeve që nënkupton njehsimin dhe matjen moderne si dhe infrastrukturën moderne të telekomunikimit; shumë blerës dhe shitës – mungesës së fuqisë së tregut nga të dyja palët; dhe kontrollit të ambientit si dhe trajtimit të subvencioneve në atë mënyrë që të mos ndërhyhet në punët në treg. Është e qartë se këto parakushte nuk ekzistojnë momentalisht në Kosovë dhe shumica nuk do të plotësohen brenda një të ardhmeje të parashikueshme. Shqyrtimi i çmimit të bërë nga ZRRE-ja ka rezultuar në një paketë të re tarifash të ndara deri nga fundi i vitit 2006 (Kapitulli 3) që do të heqë çdo ndër-subvencion si dhe do të sigurojë një kornizë QPT-je (TPA) që pasqyron kostot, por megjithatë elementë të tjerë do të vazhdojnë të mungojnë.

Nga ana tjetër, pozita e dobët financiare e KEK-ut si dhe situata dëshpëruese e sigurisë së furnizimit në Kosovë, kërkojnë një kornizë për të tërhequr investitorët privatë në gjenerim (gjithashtu edhe

konsumatorët e privilegjuar në industri) që do të kenë sektorin e shumicës me çmime konkurruese, dhe kornizën për shitje të prodhimit të tyre në tregun rajonal.

Zgjidhja që propozon ZRRE-ja është “tregu i simuluar” me çmime për orë dhe një mekanizëm balancues në kohë reale, i cili pasqyron gjenerimin e vërtetë dhe kostot e importit, në mënyrë që investitorëve të ardhshëm t’u jepet sinjali i përshtatshëm ekonomik si dhe të nxiten furnizuesit (aktualisht KEK-ut), importuesit/eksportuesit dhe konsumatorët e privilegjuar që të lidhin kontrata në mënyrën e duhur dhe të shmangin jombalancet. Modeli simulon atë që duhet të japë tregu konkurrues, pra, çmim-vënien racionale në atë formë që pasqyron një rend meritore të dispeçimit, ku mbulimi i kostove fikse bëhet kryesisht atëherë kur ka pak kapacitet rezervë. Fluksi i të ardhurave vjetore të bazuara në kosto, zvogëlon rrezikun. Rreziku i arsyeshëm josh investimet kapitale ku kërkohet kthim i lartë dhe jo ato që mbështeten vetëm mbi garancitë e çmimit. Ambienti me rrezik që mund të mbështesë kapitalin privat, punon vetëm me çmim-vënie racionale.

Modeli gjeneron: çmime që ndryshojnë çdo orë varësisht prej kërkesës – baza të çmimeve janë kostot e vlerësuara të gjenerimit (Modeli përcakton kostot fikse për çdo gjenerator, dispeçon gjeneratorët sipas rendit meritore, cakton kostot fikse përfshirë kthimin mbi investimet gjatë kohëve ku kërkesa është më e lartë në proporcion me nivelin e kapacitetit rezervë gjatë asaj kohe); modeli gjithashtu shfrytëzon vlerën e ngarkesë së humbur (VoLL) për kërkesën e pa mbuluar, e cila konsiderohet si kosto e agregatëve të vegjël të cilët shfrytëzohen së tepërmi në Kosovë. Rezultatet janë çmime të dukshëm për krahasimin dhe vlerësimin e kontratave që konsumatorët e privilegjuar mund t’i bëjnë; mekanizmi balancues që prodhon çmimet e jobalancave dhe shmangia e të cilave përcakton çmimin e tregut. Ky model do të aplikohet edhe në shqyrtimin e Çmimit të Transferit midis gjenerimit dhe furnizimit të palës dominante (KEK).

Lloji i modelit të zgjedhur është “Net Pool” me mekanizëm balancues në kohë-reale (ofertat për blerje dhe shitje të rregulluara gjatë periudhës së tranzicionit) dhe me certifikata kapaciteti për stimulimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. “Net Pool” është zgjedhur pasi ky model trajton më mirë dhe me më lehtësi tregtimin interkues apo ndërkuftar, dhe do të ishte më tërheqës për investitorët e ardhshëm të cilët do të mund që edhe të eksportojnë në tregun rajonal. Në këtë lloj tregu, shumica e energjisë vendoset përmes kontratave bilaterale, të cilat përcaktojnë energjinë e blerë/shitur në MWh për çdo periudhë barazimi të llogarive (çdo 1 orë); ekziston vetë dispeçimi dhe mekanizmi për të balancuar, ndërsa jobalancet e mbetura shkojnë në barazim të llogarive; natyrisht ekziston stimulimi për të balancuar përmes çmimeve ex-post të jobalancave, edhe pse në periudhën kalimtare fillestare ofertat për ulje dhe rritje (për shitje dhe blerje) në mekanizmin balancues do të kenë Çmim Tavan (çmime të kufizuara) të përcaktuar nga ZRRE-ja sipas kostove variabile të njëjësive. Siç u përmend më sipër, modeli prodhon çmime të simuluar të tregut për shkak të likuiditetit të pamjaftueshëm tregues për tregun e plotë. ZRRE-ja do të përdorë simulimin për të nxjerrë çmimin transferues me shumicë për gjenerimin e KEK-ut dhe do të përdorë po ashtu simulimin për çmim-vënien e ofertës për ulje dhe rritje. Modeli edhe më tej është shpjeguar në vijim. .

Në mënyrë që të stimulojë kapacitetin e reja prodhuese nga gjeneratorët e ndërtuar rishtas, dhe në mungesë të marrëveshjeve për blerjen e energjisë (PPA) afatgjata që ndalohen nga Ligji mbi Energjinë Elektrike, ZRRE-ja ka vendosur të fus në modelin e tregut Certifikatat për Disponueshmërinë e Kapacitetit (Capacity Availability Certificate - CAC). Shkurtimisht ky model është si në vijim:

- Është obligim i Furnizuesit të posedoj CAC; furnizuesi ka si detyrim të mbulojë kriterin e sigurisë (pra, kërkesa e pikut + X% rezervë marginale që përcaktohet nga ZRRE-ja)
- E shitur nga prodhuesit; prodhuesit deklarojnë disponueshmërinë dhe u japin certifikata paraprake; OST-ja ka të drejtën që në afat të shkurt kohor të njoftojë për testimin mbi këtë disponueshmëri dhe mund të kërkojë që certifikatat të kthehen në rast se ndodh ndonjë dështim; Prodhuesi mund të kthejë certifikatat në rast se këto nuk pasohen tek furnizuesit, ose përndryshe duhet të blejë certifikata të tjera nga tregu (ose të paguajë gjobën); Prodhuesit i shesin certifikatat tek furnizuesit.
- OT-ja regjistron të gjitha transferet e certifikatave; Importuesve u japin certifikata për çdo MWh të importuar (të vlefshme për orën në të cilën janë kryer importet); Eksportuesve u duhet të marrin një certifikatë për çdo MWh të eksportuar (të vlefshme për orën në të cilën

Rezervën Margjinale të kërkuar, që është sasia e kapacitetit mbi kërkesën e parashikuar e nevojshme për të siguruar sistemin e transmetimit.

Modeli inkorporon një “Mekanizëm Balancues” në kohë-reale për shmangiet nga konsumi i paraparë dhe/ose nga gjenerimi i programuar. Sidoqoftë, ofertave për ulje dhe ngritje në Mekanizmin Balancues gjatë periudhës kalimtare, do t’u vihet një kapak (do të rregullohen). Çmimi i jobalancave rrjedh si mesatare e ponderuar e çmimeve të të gjitha ofertave për ulje dhe ngritje të pranuar të pa tiketuara (dmth që do të mirren parasysh gjatë llogaritjes së çmimit për jobalanc) që gjenden në Mekanizmin Balancues dhe që janë pranuar për të zbutur apo ulur jobalancin e energjisë. Kjo do të thotë se çdo pranim që është në drejtim të kundërt me mosbalancimin e tregut, përjashtohet nga rregullimi i çmimit (pra, nëse tregu ka teprica – kërkesa e kontraktuar e tejkalon kërkesën e matur – më pas të gjitha Pranimet e Ofertave për ngritje do të injorohen sepse ato në të vërtetë kontribuojnë në teprica të mëtejshme të tregut dhe jo në balancimin e tij. Po kështu, pëlqimi i ofertave për ulje injorohet për të rregulluar çmimin e imbalancuar në tregun kur ka mungesë.

Siç u shpjegua më sipër momentalisht në prezencë të një pale dominante, modeli përlllogarit një çmim “të simuluar” tregu për çdo orë, prej të cilit do të rrjedhë çmimi transferues midis Furnizimit të KEK-ut dhe Gjenerimit të KEK-ut, mbi baza të mbulimit të plotë të kostove për gjenerim. Kjo lakore çmimi do të botohet një ditë (ose dy) përpara dhe do të veprojë si sinjal i përshtatshëm ekonomik për konsumatorët e privilegjuar, importuesit/eksportuesit dhe investitorët e ardhshëm. Qëllimi i çmimit të “simuluar” të tregut është që të përcaktojë rregulla me anë të të cilëve palët dominante do të mund të mbulojnë të hyra të rregulluara gjatë vitit, në mënyrë që do të mbizotërojnë në rast se do të ekzistonte një treg plotësisht konkurrues. Çmimet rezultuese mund të përdoren për të përcaktuar çmimin me të cilin duhet të ofrohet rezerva, si dhe çmimet të cilat duhet të vendosen për ofertat e mekanizmit balancues. Gjithashtu është edhe kriteri për të përcaktuar një paketë çmimesh të rregulluara me të cilat Furnizuesi Publik do të blejë prodhimin e Hidrocentralit Ujmani (HC); ky i fundit është i detyruar me ligj që t’i ofrojë Furnizuesit Publik prodhimin e vet. Natyra e shpërndarjes së ofruar nga kjo ndërmarrje sugjeron se një pjesë e kësaj energjie duhet të ketë çmim të energjisë bazë, por pjesa tjetër duhet të ketë çmim premium për arsye se shpërndahet gjatë periudhave të pikut.

Pala dominante duhet t’i japë ZRRE-së shpenzimet e veta variable së bashku me shpenzimet fikse të prodhimit veçmas për çdo njësi prodhuese. Kostot e njërive të gjenerimit përveç palës dominante, do të përcaktohen nga vlerësime statistikore, analiza ndërkombëtare dhe kërkimeve nga prodhuesit dhe tregtarët e linjave interkonektuese (ndërlidhëse). Kostot variable për çdo njësi gjenerimi do të përcaktohen nga shuma e këtyre kostove të shndërruara në kosto për çdo MWh të dhënë në Sistemin e Transmetimit. Këto kosto do të shfrytëzohen në modelimin vjetor të tregut Kosovar me shumicë.

Ne e konsiderojmë këtë si model në përputhje të plotë me të gjitha propozimet në Tregun Rajonal (REM) dhe na siguron fleksibilitetin maksimal për t’u integruar në zhvillimet e ardhshme rajonale. Një model grumbullues “Bruto” (ose i detyrueshëm - gross pool) do të kishte qenë më pak fleksibil për sa i përket nominimeve përmes interkonektorëve. Rezultatet e modelit gjatë formimit të çmimeve të shumicës, do të varen nga supozimet e bëra gjatë Shqyrtimit të Çmimit. Ne duhet të theksojmë se për momentin, ky është vetëm një propozim dhe se Modeli përfundimtar i Tregut duhet të zhvillohet plotësisht, të përpunohet dhe të “rafinohet” nga ITSMO-ja gjatë rrjedhës së asistencës teknike që është duke marrë aktualisht. ITSMO-ja duhet të paraqesë produktin përfundimtar për aprovim të ZRRE-ja. Ideale për ZRRE-në do të ishte që kjo të hynte në fuqi prej 1 janarit 2007.

KAPITULLI 3 METODOLOGJIA PËR TARIFAT E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE SHQYRTIMI I ÇMIMEVE

Gjatë 2005 baza për rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë elektrike nga ZRRE-ja është themeluar përmes zhvillimit dhe miratimit të dy rregullave të rëndësishëm (legjislacioni dytësor) që janë: “Rregulli mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe the “Metodologjia e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike”, plus legjislacionin shoqërues në formën e akteve rregullativ që përfshijnë “Udhëzimet e Kontabilitetit të Rregullatorit” dhe “Plani Zbatues” për Shqyrtimin e parë të Çmimit që do të mbajë ZRRE-ja gjatë vitit 2006.

3.1 RREGULLI MBI PARIMET E PËRLLLOGARITJES SË TARIFAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE (RREGULLI MBI ÇMIM-VËNIEN)

Në përputhje me Kapitullin 9 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9, Bordi i ZRRE-së ka nxjerrë Rregullin mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kosovë (“Rregulli mbi Çmim-vënien”) në sesionin publik të mbajtur më 15 dhjetor 2005. Rregulli i është nënshtruar një procesi konsultues të zgjatur.

Qëllimi

Rregulli mbi Çmim-vënien përshkruan procesin me të cilin ZRRE-ja:

- përcakton të ardhurat vjetore të lejuara që do të mbulohen prej tarifave të rregulluara nga ana e ndërmarrjeve energjetike;
- merr aplikacionet nga ndërmarrjet energjetike për aprovimin e tarifave të rregulluara; dhe
- shqyrton dhe nxjerr një vendim mbi tarifën e rregulluara.

Ky rregull përshkruan gjithashtu:

- se si mund të bëhen apelet kundër vendimeve të ZRRE-së; dhe
- kriteret për botimin e tarifave të rregulluara që janë aprovuar.

Shqyrtimi dhe aprovimi i tarifave të rregulluara

Rregulli mbi Çmim-vënien krijon dy rrugë të ndara për shqyrtimin dhe aprovimin e tarifave të rregulluara nga ZRRE-ja, në varësi të faktit se kostot që do të mbulohen nga tarifën e rregulluara janë të parapërcaktuara për një sërë vjetësh (norma të bazuara në përmbushjen e detyrave) ose vlerësohen gjatë çdo viti, në të njëjtën kohë si aplikimi i tarifave.

Sipas **normave të bazuara në përmbushjen e detyrave**, ZRRE-ja përcakton maksimumin e të ardhurave vjetore të lejuara që do të mbulohen nga një i licencuar prej tarifave të rregulluara përpara se të merret aplikimi i tarifës. Këto të ardhura vjetore janë përcaktuar për një sërë vjetësh në të ardhmen (kontroll çmimi) gjatë rrjedhës së shqyrtimit të çmimit. Parimet që administrojnë përcaktimin e të ardhurave vjetore të lejuara dhe rregullimin e tyre gjatë periudhës së kontrollit të çmimit, përcaktohen ndarazi në metodologjinë e tarifave.

Kur ZRRE-ja të ketë nxjerrë një vendim mbi të ardhurat vjetore të lejuara për periudhën e ardhshme të kontrollit të çmimit, në fund të shqyrtimit të çmimit, atëherë të licencuarit dorëzojnë një aplikacion për aprovim të tarifave të tyre të rregulluara. Ky aplikacion duhet të tregojë se të ardhurat vjetore që do të mbulohen sipas tarifave të rregulluara, janë në përputhje me të ardhurat vjetore të lejuara gjatë kontrollit të çmimit, dhe se struktura e tarifave të rregulluara është në përputhje me parimet e themeluara në metodologjinë e tarifave. Nëse gjatë shqyrtimit të aplikacionit, ZRRE-ja është e kënaqur me plotësimin e kriterëve, atëherë, tarifën do të aprovohen. Në të kundërtën, ZRRE-ja mund ose të kërkojë ndryshime në tarifën e propozuar, ose të refuzojë plotësisht aplikacionin dhe të kërkojë dorëzimin e një aplikacioni të ri.

Nëse tarifën rregullohen sipas **normave të pabazuara në përmbushjen e detyrave**, atëherë aplikacioni i tarifave duhet të përfshijë prova të kostove historike dhe kostove të parashikimit të të licencuarit, të cilat do të mbulohen nga tarifën e propozuar, si dhe justifikimin për këto. Meqenëse shqyrtimi i këtyre kostove do të marrë kohë shtesë në lidhje me aplikacionet që bëhen për normat e bazuara në përmbushjen e detyrave, nëse ZRRE-së i kërkohet që vetëm të sigurojë përputhshmëri me të ardhurat vjetore të lejuara që janë përcaktuar më herët, periudha e lejuar për shqyrtim të aplikacioneve për norma që nuk bazohen në përmbushjen e detyrave, do të jetë shumë më e gjatë.

Sipas Metodologjisë së Tarifave që ka nxjerrë ZRRE-ja, tarifën e rrjetit dhe teprica me pakicë që është fituar nga furnizuesi publik, do të përcaktohen sipas normave të bazuara në përmbushjen e detyrave.

Çmimi i tregut të stimuluar të energjisë elektrike me shumicë, dhe çmimi i rregulluar që ka rezultuar nga shitjet prej prodhuesve ekzistues, do të përcaktohet çdo vit sipas normave që nuk bazohen në përmbushjen e detyrave, duke pasur parasysh pasigurinë shumë të mëdha që rrethojnë kostot e importeve dhe programet e shpenzimeve kapitale.

Pjesëmarrja e palëve të interesuara

Rregulli mbi Çmim-vënien kërkon që ZRRE-ja të njoftojë palët e interesuara për fillimin e shqyrtimit të çmimit ose marrjen e aplikacionit për tarifa, dhe duhet t'u lejojë këtyre, kohë të mjaftueshme për komente. Ky rregull i kërkon po ashtu ZRRE-së që të mbajë dëgjime publike sa herë që të shqyrtojë tarifat e furnizuesit publik (tarifat përfundimtare që i vendosen konsumatorit jo të privilegjuar), si dhe në raste të tjera kur është e mundur. ZRRE-ja është gjithashtu e përkushtuar që sipas Rregullit mbi Çmim-vënien, të botojë në faqen e vet elektronike zyrtare, të gjithë dokumentet, të dhënat dhe materialet e dorëzuara që janë marrë nga ZRRE-ja, si dhe të gjithë dokumentet e veta që kanë të bëjnë me shqyrtimin e çmimit ose me aplikacionin për tarifë, sipas kufizimeve standarde të fshehtësisë komerciale.

Sfidat dhe apelet

Palët e interesuara kanë tre mënyra me anë të cilave mund të sfidojnë vendimin e ZRRE-së në lidhje me shqyrtimin e çmimit ose aplikacionin për tarifë. Brenda 15 ditësh, ata mund të aplikojnë për rishqyrtim të vendimit të ZRRE-së, dhe të bazohen edhe në përfshirjen e ekzistencës së provave të reja, në ndonjë ndryshim që mund të bëhet në ligj, ose në ndonjë gabim që është bërë në fakt apo në ligj. ZRRE-së i jepen 15 ditë për të përcaktuar nëse do të pranojë aplikacionin, e nëse ndodh kështu, do të nevojiten edhe 30 ditë të tjera për të ndërmarrë rishqyrtimin e vet. Në rast se e konsideron si të merituar aplikacionin, ZRRE-ja do të nxjerrë një vendim të ndryshuar.

Palët e interesuara mund të kërkojnë edhe Shqyrtimin Ekspert të vendimit të ZRRE-së, brenda 15 ditësh pasi është nxjerrë ky vendim. Nëse palët e interesuara janë të pakënaqura me rishqyrtimin ose Shqyrtimin Ekspert, atëherë ata mund të apelojnë në gjykatë për anulimin e vendimit të ZRRE-së.

3.2 METODOLOGJIA E TARIFAVE

Metodologjia e Tarifave është miratuar nga Bordi i ZRRE-së në sesionin publik të datës 15 dhjetor 2005, në përputhje me Nenin 46 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë ku kërkohet zhvillimi dhe nxjerrja e Metodologjisë.

Qëllimi

Metodologjia jep në detaje se si synon ZRRE-ja të përcaktojë mbulimin e të ardhurave vjetore të lejuara nga të licencuarit prej tarifave të rregulluara dhe parimeve që ZRRE-ja pret që tarifat e rregulluara të propozuara nga të licencuarit, të jenë në pajtim me metodologjinë.

Përcaktimi i tarifave të rregulluara

Sipas dispozitave të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, tarifat e rregulluara janë përcaktuar si tarifa që aplikohen në shitjet ndaj furnizuesit publik prej gjeneratorëve me kapacitet që i tejkalon 5MW dhe që veprojnë pas datës së shpalljes së Ligjit (30 qershor 2004), për kyçjen në dhe shfrytëzimin e rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe nga furnizuesi publik tek konsumatorët jo të privilegjuar. Tarifat e tjera, edhe pse nuk janë të rregulluara drejtpërdrejt, mbeten të nënshtruara ndaj gabimeve të ZRRE-së në rast se vendosen nga një ent dominant për të siguruar se ato pasqyrojnë kostot dhe nuk janë tepër diskriminuese. Figura 3.1 ilustron ato tarifa që janë të rregulluara dhe të parregulluara në industrinë kosovare të energjisë elektrike.

Figura 3.1 Tarifate e Rregulluara dhe të Parregulluara

	Furnizuesi Publik	Furnizuesit Tjerë	TNO	DNO	Konsumatorët e pa-privilegjuar	Konsumatorët e privilegjuar
KEK Genco	Çmimi me shumicë	Çmimi me shumicë	Pagesa për Kyçje			
IPPs	Çmimi me shumicë	Çmimi me shumicë	Pagesa për Kyçje	DUOS/ Pagesa për Kyçje		
Furnizuesi Publik			TUOS	DUOS	Çmimi me pakicë	Çmimi me pakicë
Furnizuesit Tjerë			TUOS	DUOS	Çmimi me pakicë	Çmimi me pakicë
Konsumatorët e pa-privilegjuar			Pagesa për Kyçje	Pagesa për Kyçje		
Konsumatorët e privilegjuar			Pagesa për Kyçje	Pagesa për Kyçje		

X	Tarifate e Rregulluara
X	Tarifate e pa-Rregulluara

Tarifate e rregulluara të gjenerimit

ZRRE-ja është e angazhuar për të siguruar që rregullimi i tarifave të gjenerimit, nuk do të fusë shtrembërime të reja në tregun e shumicës të energjisë elektrike, duke mbajtur për shembull çmimet e tregut poshtë kostove të investimit të ri, edhe në rast se ekziston një deficit në kapacitet. Sipas draft Rregullave të Tregut, ZRRE-ja parashikon një Model të Stimulimit të Tregut të Shumicës (MSTS), parametrat e të cilit janë aprovuar nga ZRRE-ja dhe shfrytëzohen për të përcaktuar çmimet e lejuar dhe ofertat e dorëzuara nga gjeneratorët mbizotërues, siç shpjegohet në Kapitullin 2 më sipër. Çmimet që dalin prej këtij MSTS do të shfrytëzohen edhe për përcaktimin e tarifave të rregulluara që janë vendosur nga prodhuesit ekzistues për shitjet ndaj furnizuesit publik. Kjo gjë do të sigurojë qëndrueshmërinë midis çmimeve në tregun e shumicës dhe atyre të përfshira në MBE-të me furnizuesin publik. Nëse kjo gjë do të bëjë që prodhuesit e rregulluar të fitojnë të ardhura vjetore që i tejkalojnë kostot e arsyeshme të vlerësuara nga ZRRE-ja, diferencat do t'u kthehen konsumatorëve.

Tarifate e rregulluara të gjenerimit do të shqyrtohen çdo vit në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Energjinë Elektrike, për sa i përket MBE-ve me furnizuesin publik dhe me shfrytëzimin e parashikuar të MSTS-së sipas Rregullave të Tregut

Nëse furnizuesit publik i duhet të blejë me çmime të parregulluara, atëherë ZRRE-ja do të shqyrtojë çdo vit, arsyeshmërinë e tarifave të përfshira në MBE për këto qëllime.

Tarifate e rregulluara të transmetimit dhe shpërndarjes


Kostot e operatorit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes do të mbulohen përmes tarifave të shfrytëzimit të sistemit (SHS) dhe tarifave të kyçjes.

Tarifate e qasjes

Duke marrë parasysh madhësinë e vogël të sistemit kosovar dhe sigurinë e ulët të sistemit ekzistues, kyçja e shfrytëzuesve të rinj madhorë ka gjasa të kërkojë investime të mëdha në rrjet. Për të siguruar që shfrytëzuesit i njohin këto kosto, ZRRE-ja do të kërkojë ndaj të gjithë shfrytëzuesve që kyçen në sistemin e transmetimit dhe të gjithë gjeneratorët me kapacitet që i tejkalon 5MW që qasen në sistemin e shpërndarjes, që të paguajnë tarifa "të thella" të kyçjes. Këto përfshijnë edhe kosto të kyçjes direkte në rrjetet ekzistuese dhe çdo investim të nevojshëm për të përforcuar rrjetin ekzistues për rregullimin e ngarkesës së re në vendndodhje të tjera. Shfrytëzuesit e rinj do të paguajnë një tarifë

të kyçjes së “cekët”, e cila mbulon vetëm kostot e tyre të kyçjes së drejtpërdrejtë. Diferenca midis dy tarifave është ilustruar më poshtë. Konsumatorët më të vegjël, nëse ndodhen afër rrjetit ekzistues, do të paguajnë një tarifë standarde të kyçjes së cekët.

Figura 3.2 Taksat për kyçje të thellë dhe të cekët




Transmetimit dhe OSSH-së do t'i kërkohet që të ofrojnë kushte dhe afate standarde për kyçjen, e cila do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe aprovimit të ZRRE-së. Nëse një konsumator kundërshton tarifën e kyçjes së përlogaritur nga Operatori i Sistemit, ata do të mund të apelojnë në ZRRE.

Tarifat e SHS

Kostot e tjera, përfshirë kostot e Operatorit të Tregut, do të mbulohen përmes tarifave të SHS. Sipas Metodologjisë, ZRRE-ja propozon të miratojë rregulloren e normave të bazuara në kryerjen e punës për tarifën e transmetimit dhe shpërndarjes në formën e një çmimi tavan. Kostot, përfshirë fitimet e projektuara të efikasitetit, do të parashikohen për një periudhë tre vjeçare të kontrollit të çmimit. Të licencuarit do të lejohen të mbajnë çdo përfitim shtesë që rrjedh nga reduktimi i kostove të tyre poshtë nivelit të parashikuar, deri në përfundimin e periudhës së kontrollit të çmimit. Kjo do të sigurojë stimulime që të licencuarit të zbesin kostot, e cila më pas do të jetë në të mirë të konsumatorëve duke i lejuar çmimet të zbesin për të qenë në përputhje me nivelet e reja më të ulëta të kostove gjatë shqyrtimit të ardhshëm të çmimeve. Koncepti i çmimit tavan është ilustruar në Figurën 3.3. më poshtë.

Figura 3.3 Çmimet tavan (normat e bazuara në performansë) të ilustruar



Maksimumi i të ardhurave vjetore që të licencuarit janë të lejuar të fitojnë prej tarifave të rregulluara midis shqyrtimeve të çmimeve, do të rregullohet çdo vit sipas formulës vijuese:

$$REV_t = MAR_{t-1} * (1 + CPI_t - X) * [(1 - PCAP) + PCAP * (VOL_t / VOL_{t-1})] + LOS_t + K_t$$

Ku:

REV_t të ardhurat vjetore të lejuara nga tarifat e rregulluara gjatë vitit t

MAR_t maksimumi i të ardhurave vjetore të lejuara përpara humbjeve të lejuara dhe rregullimit të korigjimit. Përcaktohet nga ZRRE-ja për të periudhën 0 përpara fillimit të çdo kontrolli të çmimit, pas kësaj, përllogaritet në përputhje me formulën.

CPI_t treguesi i çmimit të konsumatorit (inflacioni) ose tregues i ngjashëm i çmimit

X faktori real i rregullimit. Përcaktohet nga ZRRE-ja

$PCAP$ ndarja e kostove të ndryshueshme në kosto totale (ose përbërësi i çmimit tavan). Përcaktohet nga ZRRE-ja., PCAP bëhet 0 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit

VOL_t Vëllimet e transportuar

LOS_t humbja e lejuar (shihni më poshtë). Përcaktohet nga ZRRE-ja

K_t Faktori korigjues për mbi ose nën mbulimin e përbërësit fiks të të ardhurave vjetore të lejuara në vitin paraprak

Në thelb, kjo do të thotë që:

- Maksimumi i të ardhurave vjetore të lejuara në vitin aktual, (t), përllogaritet si maksimumi i të ardhurave vjetore të lejuara përpara lejimit të humbjeve dhe korigjimeve në vitin paraprak, shumëzuar me masën e rritjes të kostove (treguesi i inflacionit) minus rregullimin real (faktori X).
- Të ardhurat vjetore të lejuara për licencën e shpërndarjes janë po ashtu të rregulluara nga rritja e vëllimit në raport me pjesën e kostove të ndryshueshme në kosto totale, siç përcaktohet nga ZRRE-ja (për shembull, nëse kostot e ndryshueshme mendohet se përbëjnë 50% të kostove, dhe vëllimet totale të transportuara rriten me 10%, atëherë të ardhurat vjetore të lejuara do të rriten me 5%). Për licencën e transmetimit, të gjithë kostot mendohet se janë fikse dhe për këtë arsye, maksimumi i të ardhurave vjetore të lejuara nuk ndryshon nga vëllimet e transportuara.

- Të ardhurave vjetore të lejuara që kanë rezultuar nga përllogaritjet, u është shtuar lejimi i humbjeve (shihni më poshtë) dhe një faktor korrigjues (faktori K), i cili kompenson çdo mbi ose nën mbulim të të ardhurave vjetore të lejuara në vitin paraprak i cili rezulton nga diferencat midis vëllimeve të parashikuara dhe atyre reale të transportuara. Kjo i lë të hyrat e të licencuarit të paprekura nga vëllimet që janë transportuar realisht, për atë pjesë të kostove (dhe të ardhurave vjetore) të tyre që janë menduar si fikse.

Kur të përcaktojë kontrollin e çmimeve, ZRRE-ja do të përcaktojë vlerën filluese për të ardhurat vjetore të lejuara dhe një faktor-X të tillë, që vlera aktuale e të ardhurave vjetore të lejuara të parashikuara, (në afate reale) që është fituar nga të licencuarit gjatë periudhës së kontrollit të çmimit, të jetë në përputhje me vlerën e nivelit e kostot efikase të përcaktuar nga ZRRE-ja.

Çdo vit, të licencuarit do të dorëzojnë për shqyrtim dhe aprovim të ZRRE-së, propozimin e tyre për tarifën e rregulluar të SHS-së për vitin pasardhës. Kur të bëjë këtë, i licencuari duhet të tregojë se:

- Të ardhurat vjetore të pritura që janë fituar nga tarifën e propozuar, janë në pajtimit maksimalin e lejuar nga ZRRE-ja.
- Tarifën e propozuar pasqyrojnë kostot dhe në veçanti, të tregojnë se:
 - Struktura e tarifave korrespondon shumë me koston përkatëse marxhinale afatgjatë të furnizimit të çdo lloji të konsumatorëve me çdo nivel tensioni.
 - Baza e tarifave, pasqyron nxitësit kryesorë të kostove të të licencuarit. Për rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, ekziston nevoja për të arritur kërkesën e pikut që nxit në masë të madhe kriteret e sistemit, dhe për këtë arsye, në mënyrë që tarifën e SHS-së të mbulojnë kostot e vetë rrjeteve, këto duhet të bazohen në kontributin që çdo shfrytëzues ka në kërkesën e pikut. Tarifën që mbulojnë kostot e sistemit dhe operimin e tregut, mund të bazohen në vëllimet e energjisë, si autorizim për shfrytëzimin përkatës që u bëhet këtyre shërbimeve nga shfrytëzuesit e sistemit.

ZRRE-ja gjithashtu pret që kostot e lidhura me sigurimin e rrjetit do të mbulojnë vetëm nga konsumatorët e kërkesës, dhe jo nga prodhuesit. Aplikimi i tarifave të kycjes së thellë do të thotë që prodhuesit do të kujdesen për kostot e plota të vendimeve të tyre për vendndodhjen e rrjetit, pavarësisht nga ndonjë tarifë të SHS-së që mund të detyrohen të aplikojnë. Për këtë arsye nuk ka fitim efikasiteti nëse i kërkohet prodhuesit të paguajë tarifën e Shfrytëzimit të Sistemit, si dhe nuk mbrohen konsumatorët përfundimtarë (të cilët në fund do të detyrohen të paguajnë këto kosto pavarësisht se në cilin ent janë të lidhur). Si pasojë, është më e thjeshtë që këto kosto të caktohen vetëm për kërkesën.

Mekanizmat stimules

Të ardhurat vjetore të lejuara do të përfshijnë dy mekanizma të skicuar për të përforcuar stimujt për operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, për të maksimizuar efikasitetin e tyre dhe për të minimizuar kostot ndaj konsumatorëve. I pari prej këtyre, lidhet me humbjet. Kostot reale të humbjeve teknike dhe komerciale (diferenca midis energjisë që hyn dhe asaj që del nga rrjeti) do të paguhet prej operatorëve përkatës të sistemit ndaj furnizuesve. Për të mbuluar këtë kosto, operatorët e sistemit do të marrin një ndihmë financiare për kostot e humbjeve, të cilat do të kenë të drejtën t'i mbulojnë prej tarifave të rregulluara dhe/ose përmes kontributit nga buxheti i qeverisë. Diferencat midis nivelit të lejuar të humbjeve dhe humbjeve reale, do të mbarten nga operatorët e sistemit – duke u dhënë atyre një stimulim të fortë për të pakësuar humbjet poshtë nivelit të lejuar që ka përcaktuar ZRRE-ja.

Mekanizmi i dytë përfshin ndarjen e kostove të aksioneve nga operatori i sistemit të transmetimit, për të balancuar furnizimin dhe kërkesën përmes shfrytëzimit të mekanizmit balancues dhe kontratave rezervë (siç përshkruhet në Rregullat e Tregut). Nëse këto kosto e tejkalojnë nivelin e projektuar, një pjesë e diferencës (deri në një kufi) do të mbartet nga Operatori i Sistemit. Po kështu, Operatori i Sistemit do të mbajë një pjesë të çdo kursimi që rrjedh nga pakësimi i kostove poshtë niveleve të parashikuara.

Tarifat e rregulluara të pakicës

Tarifat e pakicës ose ato përfundimtare që janë u vendosur konsumatorëve jo të privilegjuar nga furnizuesi publik, do të përfshijnë shumën e kostove të blerjes së energjisë, tarifën e rregulluar të transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe një ndihmë financiare për kostot e vetë furnizuesit publik, përfshirë një tepriçë të lejuar përfitimi që e kompenson furnizuesin publik kur merr përsipër rreziqe.

Kostot e lejuara dhe teprica e përfitimit, do të rregullohen sipas një çmimi tavan tre vjeçar, i ngjashëm me atë që aplikohet për Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe atij të Shpërndarjes.

Furnizuesi publik do të propozojë çdo vit tarifa të rregulluara. Këto do të kalojnë përmes kostove të rregulluara të blerjes së energjisë, kostove balancuese dhe tarifave të rrjetit. Kostot balancuese do t'i nënshtrohen një mekanizmi stimulues, ku furnizuesi publik mban një pjesë të kostove të tepërta në krahasim me nivelin e lejuar nga ZRRE-ja, dhe merr një pjesë të çdo rënieje të kostove poshtë këtij niveli, për shkak të kapakëve (kufijve) që vihen në shumën maksimale që mund të paguhet ose të fitohet prej këtij mekanizmi.

Duke propozuar tarifa të rregulluara, furnizuesit publik do t'i kërkojë që sigurojë që këto tarifa reflektojnë kostot dhe për aq sa është e mundur, do të përçojnë të njëjtën strukturë dhe baza tarifore të inkorporuara në tregun e rregulluar të shumicës dhe në tarifatat e rrjetit.


Plotësimi i nevojave sociale

ZRRE-ja me anë të rregullimit të tarifave, merr parasysh nevojën për forcim të kohezionit social dhe ekonomik nëpër Kosovë. Metodologjia e Tarifave e pasqyron këtë në dy mënyra:

- Tarifatat e rregulluara për çdo kategori konsumatorësh do të jenë uniforme në të gjithë Kosovën.
- Furnizuesi publik pritet të ofrojë një bllok-tarifë rritëse për konsumatorët shtëpiakë, sipas cilës konsumatorët që konsumojnë brenda bllokut të parë, do të kenë tarifë më të ulët, dhe diferenca do të paguhet me anë të tarifave më të larta që u janë ngarkuar konsumatorëve të cilët kanë konsum përmbi këtë nivel.

Koncepti i bllok tarifës rritëse është ilustruar në Figurën 3.4. Në përputhje me legjislacionin administrues, ndër-subvencionet do të ekzistojnë vetëm brenda kategorisë së konsumatorëve shtëpiakë dhe jo midis kategorive të ndryshme të konsumatorëve.

Figura 3.4 Ilustrimi i “Bllok tarifës rritëse”



KAPITULLI 4 LEGJISLACIONI SEKONДАР– MBROJTJA E KONSUMATORËVE

4.1 LEGJISLACIONI SEKONДАР

në përputhje me Nenin 15.1 të Ligjit 2004/9 “mbi Rregullatorin e Energjisë”, ZRRE-ja është përgjegjëse për krijimin dhe forcimin e një kornize rregullative për sektorin energjetik në Kosovë, duke siguruar mos-diskriminimin, konkurrencën efektive dhe funksionimin efikas në tregun e energjisë.

Gjatë vitit 2005, ZRRE-ja ka arritur përmbushje madhore në kompletimin e kornizës rregullative duke zhvilluar, nxjerrë dhe miratuar me Procedura të Konsultimit Publik, disa akte të legjislacionit dytësor në formën e Rregullave, Akteve, Dekreteve, Udhëzimeve, Direktivave dhe Vendimeve.

Të gjithë rregullat e ZRRE-së janë përgatitur në këshillim me disa palë të interesuara, Ministri, kompani energjetike, donatorë, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me konsulentët e financuar prej USAID-it dhe AER-it.

Rregullat në formën e drafteve janë botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së dhe të gjithë palët e interesuara janë të informuar rreth këtij botimi, të paktën 2-3 javë përpara dëgjimit publik. Për qëllim që palët e interesuara të kenë mundësinë të sigurojnë komente me shkrim, ZRRE-ja ka krijuar një adresë e-maili. Pas përcaktimit të afatit përfundimtar për komentim rreth drafteve, ZRRE-ja shpall një datë dhe agjendën për dëgjimin publik, si dhe fton palët e interesuara që të marrin pjesë.

Brenda pak javësh, ZRRE-ja mbledh komentet e marra dhe një anëtar i Bordit të ZRRE-së (ose anëtar i caktuar i stafi të ZRRE-së) i prezanton draftin dhe lexon të gjithë komentet që janë marrë përpara ose gjatë dëgjimit publik, shpjegon arsyet se pse disa komente janë pranuar ose jo, dhe i jep publikut mundësinë që të komentojë edhe më tej. Bordi voton mbi draftin dhe vendos me shumicë vote. Më pas, versioni përfundimtar i Rregullit të miratuar botohet në faqen elektronike të ZRRE-së dhe bëhet informimi i duhur i palëve të interesuara.

Rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja

a) Kodi i Sjelljes dhe Etikës

Kodi i Sjelljes dhe Etikës i nxjerrë nga ZRRE-ja, paraqet parimet etike dhe rregullat drejtuese të sjelljes që udhëheqin stafin dhe Bordin e Anëtarëve të ZRRE-së. Kodi është botuar më 10.12.2005 në formën e një drafti. Më 17.11.2005 është mbajtur një dëgjim publik dhe më pas është miratuar nga Bordi i ZRRE-së më 15.12.2005.

b) Statuti i ZRRE-së

Statuti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë përcakton strukturën e brendshme, organizimin, përfaqësimin, autoritetin, procesin vendimmarrës, rendin e aktiviteteve, procedurën për punësimin e stafit, si dhe përgjegjësitë e anëtarëve të stafit në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”). Statuti është botuar në formën e draftit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së më 10.12.2005. Më 17.11.2005 është mbajtur një dëgjim publik dhe më 15.12.2005 është bërë miratimi i Statutit nga Bordi i ZRRE-së.

c) Rregulli mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulli mbi Çmim-vënien)

Ky Rregull përcakton parimet për përlllogaritjen dhe aprovimin e tarifave të rregulluara në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, si dhe procedurat për dorëzimin, shqyrtimin, modifikimin, aprovimin dhe mbikëqyrjen e tarifave të rregulluara nga ndërmarrjet energjetike. Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 27.09.2005 në formën e një drafti. Më 17.11.2005 është mbajtur një dëgjim publik dhe më 15.12.2005 është bërë miratimi i tij nga Bordi i ZRRE-së.

d) Metodologjia e Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike

Metodologjia mbulon përcaktimin e totalit të të ardhurave vjetore të lejuara që mund të fitohen nga tarifat e rregulluara, dhe parimet administruese të strukturës së tarifave që përdoren për të mbuluar këto të ardhura vjetore. Të licencuarit kanë përgjegjësinë të propozojnë për shqyrtim dhe miratim nga ZRRE-ja, tarifat e rregulluara që janë në pajtueshmëri me të ardhurat vjetore të lejuara që ka përcaktuar ZRRE-ja. Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të tarifave të rregulluara, është përcaktuar në Rregullin për Përlllogaritjen e Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike më sipër. Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 25.10.2005 në formën e një drafti. Më

17.11.2005 është mbajtur një dëgjim publik dhe më 15.12.2005 është bërë miratimi i tij nga Bordi i ZRRE-së.

e) Rregulli mbi Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

Ky rregull përcakton procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat:

- E konsumatorëve kundër të licencuarve në lidhje me shërbimet e dhëna;
- E të licencuarve kundër të licencuarve të tjerë në lidhje me kryerjen e aktivitetit të licencuar;
- Në lidhje me QPT në rrjetet e transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike apo gazit natyror, dhe me transmetimin ndërkuftar të energjisë elektrike ose gazit natyror.

Ky rregull ka përcaktuar procedurën bazë që aplikohet për ankesat e konsumatorëve dhe detyrimet e të Licencuarit në lidhje me ankesat e konsumatorëve, zgjidhjen e ankesave nga ZRRE-ja, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, si dhe monitorimi i Procedurave të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve në sektorin energjetik.

Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 05.12.2005 në formën e një drafti. Më 14.12.2005 është mbajtur një dëgjim publik dhe më 17.01.2006 është bërë miratimi i tij nga Bordi i ZRRE-së.

f) Rregulli mbi Planin e Taksave

Ky rregull specifikon kategoritë dhe sasinë e taksave të përcaktuara në Nenin 23 dhe 24 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, për qëllime të financimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), si dhe procedurat dhe afatet përfundimtare për pagimin dhe pasojat e mospagimit të këtyre taksave. Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 05.12.2005 në formën e një drafti. Më 14.12.2005 është mbajtur një dëgjim publik dhe më 17.01.2006 është bërë miratimi i tij nga Bordi i ZRRE-së.

g) Rregulli mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë

Ky rregull krijon një procedurë publike, transparente dhe jo-diskriminuese të licencimit, që promovon krijimin e funksionimit të një tregu energjetik konkurrues, si dhe stimulon investimet ndërkohë që ofron siguri dhe qëndrueshmëri të sektorit energjetik në Kosovë. ZRRE-ja ka zhvilluar aplikacionet për Licencë dhe ka zhvilluar 9 forma gjenerike të Licencave për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe NQ:

- Licenca për Gjenerimin e Energjisë Elektrike
- Licenca për Gjenerimin e Ngrohjes
- Licenca e Transmetimit
- Licenca e Operimit të Tregut
- Licenca për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike
- Licenca për Shpërndarjen e Ngrohjes
- Licenca për Furnizim/Tregtimin të Energjisë Elektrike
- Licenca për Furnizimin Publik të Energjinë Elektrike
- Licenca për Furnizimin Publik të Ngrohje

Edhe pse Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë merr masa edhe për licencat e gazit natyror, gazi natyror nuk i nënshtrohet Rregullit mbi Licencimin meqenëse Ligji mbi Gazin Natyror nuk është shpallur ende. ZRRE-ja parasheh përgatitje të shpejtë të këtij ligji dhe më pas edhe miratimin e një Rregulli përkatës për Licencimin e Gazit Natyror, si legjislacioni dytësor i veçantë.

Rregulli mbi Licencimin ka paraparë se ndërmarrjet energjetike të energjisë elektrike dhe ngrohjes, do të aplikojnë për licenca deri më 24 qershor 2006 dhe ZRRE-ja do t'u japë licencat brenda 90 ditësh prej ditës së aplikimit.

Forma e aplikimit për licencë është po ashtu e zhvilluar dhe botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

h) Rregulli mbi Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve

Ky rregull përcakton kriteret, termat, kushtet me anë të të cilave, ndërmarrjet energjetike mund të shkycin dhe ri-kyçin konsumatorët në sektorin energjetik në Kosovë, dhe përcakton standardet,

parimet dhe procedurat e aplikueshme. Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 27.01.2006 në formën e një drafti. Më 14.02.2006 është mbajtur një dëgjim publik dhe më 24.02.2006 është bërë miratimi i tij nga Bordi i ZRRE-së.

i) Rregulli mbi Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

Synimi i përgjithshëm i këtij rregulli, është të paraqesë detyrime dhe përgjegjësitë e furnizuesit dhe konsumatorit, si dhe operatorëve të rrjetit në sektorin e energjisë. Ky përshkruan marrëveshjen për furnizim, kyçjen në rrjet, matjen, faturimin dhe pagimin e energjisë. Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 24.02.2006 në formën e një drafti. Më 27.04.2006 është paraparë të mbahet një dëgjim publik dhe miratimi i tij të bëhet në mes të muajit maj 2006.

j) Rregulli mbi Procedurat Autorizuese për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese

Ky rregull trajton ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe/ose rehabilitimin e plotë të kapaciteteve të vjetra. Ky përshkruan aplikimin, kriteret, privilegjueshmërinë, vlerësimin dhe elementët të tjerë të rëndësishëm të procedurave autorizuese, të cilat i mundësojnë aplikantit që të aplikojë për leje ndërtimi të kapacitetit të ri dhe/ose rehabilitim. . Ky rregull është botuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, më 24.02.2006 në formën e një drafti. Më 14.03.2006 është mbajtur një dëgjim publik dhe është paraparë që miratimi i tij të bëhet në fund të muajit maj 2006.

Për shkak të rëndësisë së këtij Rregulli, nevojitet një periudhë më e gjatë diskutimesh, takimesh dhe bashkëpunimesh me palët e interesuara.

k) Rregulli mbi Regjistrin Publik

Ky rregull përcakton procedurat për mbajtjen e regjistrit publik të licencave të dhëna, certifikatave të privilegjueshmërisë dhe certifikatave të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Ky rregull është finalizuar dhe do t'i nënshtrohet miratimit nga Bordi i ZRRE-së në maj 2006.

l) Rregulli mbi Fshehtësinë e informacioneve

Ky rregull trajton të dhëna dhe informacione të llojeve të ndryshme që duhet të konsiderohen si të fshehta dhe nuk mund të hapen në publik. Drafti është përgatitur dhe do t'i nënshtrohet dëgjimit publik menjëherë pas miratimit të Rregullit mbi Autorizimin.

m) Rregulli mbi Masat Administrative dhe Gjobat

Ky Rregull bazohet në Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe përcakton gjobat dhe masat administrative që ZRRE-ja mund t'u japë ndërmarrjeve energjetike. Drafti është përgatitur dhe do t'i nënshtrohet dëgjimit publik menjëherë pas miratimit të Rregullit mbi Autorizimin.

Vendime dhe Udhëzime të tjera të nxjerra nga ZRRE-ja gjatë 2005:

Vendimi D_01_2005 për aprovimin e kriterëve që përcaktojnë dhe përllogarisin shfrytëzimin e paaautorizuar të energjisë elektrike

Vendimi D_02_2005 për aprovimin e kërkesës së KEK-ut në lidhje me Procedurat e Shkyçjes.

Vendimi D_03_2005 mbi Procedurat e Kyçjes dhe Çmimet

Vendimi D_04_2005 mbi aprovimin e Tarifave të ngrohjes për KNQ "Gjakova" gjatë 2005-2006

Vendimi D_05_2005 mbi aprovimin e Tarifave të ngrohjes për KNQ "Termokos", për sezonin 2005-2006

Vendimi D_06_2005 2005 mbi aprovimin e Tarifave të ngrohjes për "Termomit", për sezonin 2005-2006

Vendimi D_07_2005 mbi aprovimin e Tarifave të ngrohjes për KNQ "Zvečan" gjatë 2005-2006

Vendimi D_08_2005 mbi aprovimin e Kërkesës së KEK-ut në lidhje me "Politikën ABC"

Udhëzimi i Përkohshëm I_01_2005 mbi raportimin ndaj Rregullatorit nga ana e Ndërmarrjeve të Ngrhjes Qendrore

Udhëzimi i Përkohshëm I_02_2005 mbi Parimet për Përllogaritjen e Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrhjes Qendrore për Sezonin e Ngrhjes 2005/2006

4.2 MBROJTJA E KONSUMATORËVE

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRRE është përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin energjetik në Kosovë. DMK-ja është themeluar plotësisht në mars të 2005, dhe ka qenë i përfshirë në detyra që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve:

- Pjesëmarrja në hartimin dhe komentimin e legjislacionit dytësor në lidhje me konsumatorët.
- Analizimi i të dhënave që janë marrë nga KEK-u, duke u fokusuar në ankesat e konsumatorëve.
- Pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurave të KEK-ut mbi: Shkyçjen, Rregullimin e Borxhit, Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, Tarifat, Gjobat, etj, për të siguruar që procedurat e propozuara nuk janë diskriminuese dhe se të gjithë konsumatorët janë trajtuar njësoj.
- Koordinimi i aktiviteteve me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më lidhje me stimujt për krijimin e Shoqatës së Konsumatorëve. Për këtë çështje janë mbajtur dy takime.
- Analizimi dhe shqyrtimi i politikës së skemës së ngarkesave, e ashtuquajtur Politika ABC.
- Pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta UNMIK(PSSP) – IPVQ (KM) mbi **“Furnizimin me Energji Elektrike, Faturimin dhe Mbledhjen e të Ardhurave Vjetore”**. Task Forca e Përbashkët është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të koordinuar të mbështetjes institucionale për përmirësimin e normalizimit të marrëdhënieve midis KEK-ut dhe konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë; këto kanë rezultuar me (i) nënshkrimin e kontratave përkatëse të furnizimit, (ii) zgjidhjen e (a) borxheve dhe (b) mbulimin e të ardhurave vjetore për konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike në të kaluarën, dhe (iii) pagimin e rregullt të konsumit aktual dhe të ardhshëm. Masat e marra nga Task Forca e Përbashkët gjatë 2005:
 - Përgatitja e listës përmbledhëse të detyrave dhe veprimeve që do të ndërmerren, si dhe përgjegjësitë që janë caktuar për çdo veprim brenda kufinjve të ligjit të aplikueshëm.;
 - Organizimi i diskutimeve publike/ fushatë vetëdijesimi në disa nga komunat e Kosovës.
 - Fushata mediave për vetëdijesimin e konsumatorëve mbi pagimin e faturave të energjisë elektrike.
- Përgatitja e formave për ankesat e konsumatorëve në DMK, dhe Regjistri i Ankesave të Konsumatorëve në DMK.

DMK e ZRRE-së ka përgatitur Kodin e parë të Energjisë në Kosovë për të Drejtat dhe Detyrimet, 300 kopje të të cilit i janë shpërndarë konsumatorëve të KEK-ut

KAPITULLI 5 PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMEVE TË ARDHSHME NË GJENERIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

5.1 HISTORIKU

Studimi për Investimet në Gjenerim (Generation Investment Study - GIS) është financuar nga Bashkimi Evropian dhe është përgatitur nga Pricewaterhouse Coopers LLP & Atkins International. Objektivi kryesor i këtij studimi, është të asistojë Komunitetin Evropian, Institucionet Ndërkombëtare Financuese dhe organizma të tjerë donatorë, për të identifikuar një listë prioritare treguese për investime në gjenerimin e energjisë dhe në infrastrukturën e energjisë elektrike sipas perspektivës rajonale. Ky e identifikon Kosovën si një nga vendet më joshëse për zhvillimin e gjenerimit me kosto më të ulëta. Qeveria e Kosovës (MEM) ka nxjerrë “Strategjia Energjetike e Kosovës”, sipas së cilës linjiti autokton që është në dispozicion, duhet të sigurojë mundësitë për zhvillimin dhe vënien në funksion të TEC-eve të rinj, e për më tepër, Prodhuesit e pavarur të Energjisë (IPP), inkurajohen të investojnë në sektorin energjetik duke furnizuar tregun vendor të energjisë elektrike, ndërkohë që u lejon atyre të eksportojnë sasi të mëdha energjie elektrike në tregun rajonal. Kjo pasohet nga një stuhitë studimesh që synojnë të identifikojnë bazën për zhvillimin e Gjenerimit të ri Energjetik, që do të thotë:

- *“Sibovci-Plani Kryesor për Shfrytëzimin Minerar”*
Burimet gjeologjike të Sibovcit janë vlerësuar të kenë gati 990 milionë tonë në një zonë prej 19.7 km². Studimet parashikojnë se 140 milionë tonë linjit i shfrytëzueshëm do të përdoret nga centralet energjetike ekzistuese (KEK), ndërsa pjesa tjetër prej 690 milionë tonë do të përdoret nga prodhuesit e rinj privatë. Rezervat që i mbeten prodhuesve privatë janë të mjaftueshme për të gjeneruar 15 TWh/vit për 40 vjet, me koston e supozuar prej 6.84 euro/ton deri në 8.69 euro/ton, me një Mesatare të Ponderuar prej 10% deri në 15%. Bazuar në koston e linjtit, çmimi i energjisë elektrike mendohet të jetë 35 euro/MWh deri në 42 euro/MWh (me një Mesatare të Ponderuar prej 12% - 15%) në varësi të teknologjisë dhe normës së kthimit të investitorit.
- *“Studimi i Zbatueshmërisë Ekonomike dhe Teknike për Rehabilitimin e njësisë të Kosovës A”*
- *“Studimet e para-zbatueshmërisë për centralin e ri me djegie linjiti dhe për masat e zbatjes së ndotjes në centralin Kosova B”*

Struktura e gjenerimit të ardhshëm të energjisë

Gjenerimi i energjisë në një të ardhme të afërt 2006–2015 do të fokusohet në plotësimin e kërkesës së konsumatorëve vendorë me çmime të qëndrueshëm, të pandërprerë dhe konkurrues, si dhe eksportimin e suficiteve të energjisë në tregun rajonal dhe më gjerë. Për këtë arsye, nevojitet si vijon:

- Operim normal i TEC-it Kosova B dhe HC Gazivodë/Ujman;
- Rehabilitimi i TEC-it Kosova A (bazuar në konkluzionet e studimit të zbatueshmërisë);
- Fillimi i operimit të njësisë të reja të TEC-it me kapacitet të instaluar prej rreth 1,000 MW përmes partnerëve strategjikë, veçanërisht me investime të përbashkëta.;
- Ndërtimi me koncesion i HC Zhuri, bazuar në studimin e zbatueshmërisë;
- Stimulimi i TEC-ëve të vegjël nga investitorët privatë.

5.2 STUDIMET E PARA-FIZIBILITETIT RRETH REHABILITIMIN E TC KOSOVA A

Përshkrimi dhe objektivat e projektit

Synimi i Projektit ishte të sigurojë këshilla në lidhje me furnizimin afatmesëm me energji në Kosovë, të sigurojë analiza dhe të nxjerrë konkluzione në lidhje me çështjet kryesore që kanë të bëjnë me TEC-in Kosova A. Duke marrë parasysh vlerësimin teknik, Projekti ka kryer një vlerësim ekonomik për koston dhe përfitimet, me analizë të ndjeshme për parametrat e ndryshueshëm, dhe ka

përlllogaritur normën e brendshme të kthimit si dhe kriteret e tjera ekonomike përfaqësuese për çdo skenar.

Vlerësimi Teknik

Tabela 5.1 jep rezultatet dhe orientimet që janë përshkruar në raport. Duke u bazuar në kriteret teknike, nuk është rekomanduar që të bëhet një Rehabilitim Kapital (RK) për A1, pasi ajo është një njësi shumë e vjetër (43 vjeçare) me kapacitet prodhimi të kufizuar dhe pa ri-nxjehje. Për shkak të zbatueshmërisë relativisht të mirë, (në krahasim me njësitë e tjera të Kosovës A), duhet të kryhet një Rinovim Kapital Madhor në mënyrë që A1 të mbetet në funksion deri në 2012, kur është edhe fundi i jetës së tij. Është i këshillueshëm RK i njëjësive A3, A4 dhe A5. Por meqenëse KEK-u ka vendosur të riparojë urgjentisht njësinë A3, kjo modifikon perspektivën për të aplikuar Rehabilitimin Kapital në njësinë A3 në një të ardhme të afërt. Projekti tashmë ka sugjeruar një Rinovim Kapital Madhor, por megjithatë vendimi përkatës do të merret në përputhje me rivlerësimin ekonomik, duke marrë në shqyrtim statusin e ri aktual të njësisë. Për momentin, A5 është duke funksionuar me kapacitet mesatar neto prej 110 MW dhe është një aset i vlefshëm për operimin. Për këtë arsye, RK nuk mund të ndodhë përpara përfundimit të RK-së së njësisë A4. pa asnjë mundësi për t'u ri-caktuar menjëherë në funksion, njësia A4 është njësia e parë që rekomandohet për RK. Kostot e RK-së janë të ngjashme për njësitë A4 dhe A5, me një investim prej 60 milionë eurosh, ndërsa Rinovimi Kapital Madhor për A3 duhet të kushtojë 24 milionë euro.

Tabela 5.1 Rezultatet e studimit të fizibilitetit për Rehabilitimin e njëjësive të TC “Kosova A”

		A1	A3	A4	A5
Aktuale	Dizajni	Sh. i vjetër	I vjetër	I vjetër	I vjetër
	Jetëgjatësia e mbetur	1/2 years	1/2 years	1/2 years	2/3 years
	Eficienca	Sh. e ulët	E ulët	E ulët	E ulët
	Disponueshmëria h/y	15 %	0 %	0 %	63 %
	Kapaciteti	30 MW	0	0	130 MW
Përmirsimet Teknike	Kazani	MO	MO	CR	CR
	Turbina	MO	MO	CR	CR
	C&I	NPM	MO	CR	CR
	BOP	MO	MO	CR	CR
	Elektrike	NPM	MO	CR	CR
	Ftohësi	MO	MO	CR	CR
Performanca e re	Jetëgjatësia e mbetur	7 vite	12 vite	17 vite	20 vite
	Eficienca	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët
	Disponueshmëria h/y	4,700	5,500	6,600	6,600
	Kapaciteti Bruto MW	42	125	165	171
	Kapaciteti Net MW	35	110	150	155
	Thëngjilli t/MWh net	2.1	1.9	1.7	1.7
	Siguria	E prapëteshme	E prapëteshme	E mirë	E mirë
Kostot x 1,000€	Kazani	5,050	13,165	37,352	37,352
	Turbo-gjeneratori	1,365	2,050	6,875	7,125
	Paisjet Elektrike.	900	1,000	3,800	3,500
	C&I	500	4,700	4,700	4,700
	BOP & cond.	885	1,970	6,050	6,050
	Ftohësi	750	1,500	1,500	1,500
	Paisjet ndihmëse	-	-	5,700	-
GJITHSEJ	9,450	24,385	65,977	60,227	
Rekomandimet e konsulentëve		MO ASAP	MO 2005	CR 2007/08	CR 2008/09
		FS 2010/12	FS 2015/20	MO 2012	MO 2013
Shpenzimet specifike të rehab. €/kW		225	195	400	352
IRR>25 %	A4			E lartë	
IRR=15 %-25 %	A4+A5			Mesatare	
IRR=5 %-15 %	(A4+A5) + A3			A3 i pranueshëm në rast të HGS & MGS	
IRR: Norma e Brendshme e Rentabilitetit					
MO: Rehabilitim i madh - CR: Rehabilitim Kapital- FS: Ndalje e fundit					

Vlerësimi Ekonomik

Norma e brendshme e Rentabilitetit (IRR-NBR) është gjithmonë më e lartë se 10% në skenarin e mesëm të kërkesës në rritje me dy njësi të rehabilituara, pavarësisht nga kostoja e importit të energjisë deri në vitin 2020. Me vetëm një njësi të rehabilituar, NBK-ja është më shumë se 10% në çdo rast, dhe rritet me më shumë se 20% në skenarin e lartë të rritjes së kërkesës. RK-ja e tre njëjësive është

joshëse nga aspekti ekonomik, nëse rritja e kërkesës është e lartë (më shumë se 6%) dhe nëse kostoja e importit të energjisë mbetet i lartë. Rezultatet më të mira ekonomike fitohen nga RK-ja e A4 dhe A5.

Vërejtje e rëndësishme

Sipas AKM-së, vlerësimi i koston shtesë për hapjen e një miniere të re, dallon midis 125 dhe 175 milionë euro, por zgjerimi i shfrytëzimit mineral nuk ka qenë në fushëveprimin e këtij studimi; si pasojë, ky çmim nuk është përfshirë në koston e rehabilitimit. Siç është përmendur në Kapitullin 1, prodhimi vjetor i linjtit në 2005 ka qenë 5.7 milionë tonë, për gjenerimin e 3.4 TWh prej Kosovës A1, A5 dhe Kosovës B. Nëse më shumë se tre njësi do të furnizoheshin njëkohësisht, kërkesa për qymyr do të rritet prej 7.5 milionë tonë në 2007, deri në 10.3 milionë tonë në 2009, ndërsa me nivelin aktual minierat e prodhimit të linjtit që janë në aktivitet do të shteroheshin plotësisht deri në vitin 2012, me një prodhim të reduktuar prej vitit 2009 e tutje.

Rekomandime

Projekti ka sugjeruar si kriter vendimin vijues për rehabilitim: “nëse kostoja specifike e rehabilitimit është më e ulët se energjia ekuivalente e importuar, plani rehabilitues është plotësisht i justifikuar, dhe rekomandohet fuqimisht”. Rezultati i studimit shpie në 65.9 milionë euro për RK-në e njësive A4 dhe 60.2 milionë euro për RK-në e njësive A5. Dallimi midis njësive bëhet për shkak të domosdoshmërisë për të shtuar një kosto shtesë prej 5.7 milionë eurosh për rehabilitimin e pajisjeve ndihmëse që janë të përbashkëta për të gjithë njësitë, dhe që duhet bërë për rehabilitimin e njësive së parë. Duke marrë parasysh se RK-ja do të aplikohet fillimisht për njësine A4, kostoja specifike e rehabilitimit mendohet të jetë 400 euro/kW (kapaciteti bruto 165 MW me një kosto prej 60.2 milionë eurosh plus 5.7 milionë euro); për RK-në e dytë, (njësia A5) kostoja specifike e rehabilitimit do të jetë vetëm 352 euro/kW. Është përafërsisht një e treta e një njësie të re të ngjashme, duke marrë parasysh koston e tyre specifike mesatare, sipas tregut ndërkombëtar: 1,100 euro/kW për këtë diapazon kapaciteti.

5.3 KAPACITETI I RI I GJENERIMIT TERMOCENTRALI KOSOVA C

Studimi i para-zbatueshmërisë për centralin e ri energjetik me djegie linjiti dhe masat e zbutjes së ndotjes në centralin Kosova B

Është ndërmarrë një studim para-zbatueshmërie mbi kriterin se do zhvillohet një termocentral i ri së bashku me një minierë të re mbi fushën e linjtit në Sibovc. Është supozuar se investitori i huaj ose një grup investues do të kenë rol udhëheqës në minierë dhe në zhvillimin e centralit energjetik meqenëse burimet financiare në Kosovë janë të pakta.

Linjiti i Sibovcit

Fusha e Sibovcit përmban diku 840 milionë tonë linjit përveç totalit prej 200 milionë tonë që janë planifikuar të ruhen për furnizimin e centraleve ekzistues të Kosovës A dhe B. Kjo minierë do të jetë një vazhdim i Bardhit në cepin jugperëndimor të fushës së re. Më 2004 Vattenfall ka bërë një studim zbatueshmërie për zhvillimin e minierës. Është arritur në përfundimin se kostoja e lëndës djegëse të linjtit që është në dispozicion nga miniera e re, është një nga më të ulëtat në të gjithë Evropën, duke e bërë gjenerimin e energjisë nga linjiti kosovar, një gjë shumë joshëse. Burimi i mbetur i linjtit prej pothuaj 650 milionë tonë do të bënte të mundur ndërtimin e një centrali energjetik me kapacitet prej 2,000 MW. Miniera mund të furnizojë centralin me ngarkesë të plotë dhe për një kohëzgjatje prej 40 vjetësh. Është supozuar se investitorët do të zhvillojnë aktivitetet e shfrytëzimit mineral në mënyrë të pavarur nga miniera e KEK-ut

Përlllogaritjet e para-zbatueshmërisë– kostoja e centralit të ri energjetik

Studimi i para-zbatueshmërisë konkludon se kostoja e ndryshueshme e centralit të ri energjetik në Kosovë, do të jetë në një shtrirje prej 10-12euro/MWh. Kjo krahasohet mirë me çmimet kufitare të sistemit të tregut të EJK të vlerësuara në raportin e REBIS GIS, ku edhe çmimet kufitare më të ulëta të sistemit janë rreth 17euro/ MWh në rast të rritjes së ulët të kërkesës dhe reshjeve të mjaftueshme të shiut. Kjo ilustron konkurrencën e lartë të depozitave të linjtit në Kosovë. Në raste të tjera të studimit të REBIS GIS, çmimet e llogaritura kufitare të sistemit, të cilat mund të interpretohen edhe si çmime

absolutisht minimale të tregut të hapur, mbeten përmbi 20euro/MWh. Çmimet aktuale të tregut janë 40euro/MWh e përmbi.

Tiparet skicuese të termocentralit

Studimi ka analizuar dy kapacitete alternative të njësive, përkatësisht 300 dhe 500 MW. Është supozuar se centrali i ri do të jetë në gjendje të veprojë me ngarkesë të plotë, pra ngarkesë bazë në të gjithë kushtet e tregut. Projekti ka supozuar se centrali do të ndërtohet në dy faza, që janë 900-1,000 MW gjatë fazës së parë, (3 x 300 MW ose 2 x 500 MW), ku njësitë e para veprojnë prej vitit 2012-2014, dhe faza e dytë (4 x 300 MW, alternativ 2 x 600 MW ose 2 x 500 MW) do të fillojë kur faza e parë të ketë treguar aftësinë për të gjeneruar dhe për të shitur energji në treg. I gjithë centrali 2,000 MW do të përfundojë diku nga 2018-2020.

Vendi i centralit energjetik dhe marrëveshjet e përgjithshme të bllokimit të energjisë

Përdorimi i madh i linjtit duhet të ndodhë afër minierës pasi ka vlerë të ulët kalorifike për peshë dhe rezulton në kosto të lartë transportimi. Për bartjen deri në central, do të përdoret një i ashtuquajtur “central në zgavër të minierës”, me shirita transportimi. Përveç kësaj, duhet gjetur vendi i duhur për gjuajtjen e hirit që rezulton nga vënia në funksion. 650 milionë tonët e linjtit do të konvertohen gradualisht në 600 TWh energji elektrike dhe në 100 milionë tonë hi gjatë 40 vjetërve të aktivitetit. Janë analizuar në detaje tre vendet potenciale përreth fushës së Sibovcit: Kosova B, Bivolaku dhe lugina në veri të Grabovcit, që gjendet në pjesën perëndimore të fushës. Të gjitha këto vende janë brenda 3 kilometrash prej fushës dhe mund të futen në përdorim. Projekti rekomandon vendin e Kosovës B, me kusht që të jepen siguri të mjaftueshme ndaj investitorëve të huaj që ai nuk do të jetë i rrezikuar nga ndonjë ndotje ekzistuese e vendit. Duhet larguar 15 milionë tonët e hirit përtej centralit të Kosovës B, në mënyrë që të krijohet hapësirë për kantierin e ri të rezervave të linjtit. Kostoja e heqjes së hirit është përllogaritur të jetë rreth 52 milionë euro. Vendi në Grabovc do të ofronte një vend më pak të dukshëm dhe në të ardhmen do të shkurtonte distancën transportuese të linjtit, pasi është hamendësuar se minierat e tjera të linjtit pas Sibovcit do të jenë në jug.

Koncepti i Centralit Energjetik dhe teknologjia e aplikuar

Centrali i ri do të aplikojë teknologjinë më të fundit dhe më të suksesshme në dispozicion, për centralin energjetik me avull për djegien e linjtit. Metodën e tij për kontrollimin e ndotjes, do të jenë në përputhje me kërkesat e rregullave aktuale të BE-së. Për djegien e linjtit në njësi 300 MW, mund të përdoret teknologjia moderne “Circulated Fluidized Bed - CFB”. Meqenëse karburanti përmban gur gëlqeror, desulfurizimi ndodh gjatë procesit të djegies në kazan dhe mund të pritet një emetim shumë i ulët sulfurdioksidi (SO₂). Në rastin e njësive prej 500 MW përdoret një ndezje më konvencionale “Pulverized Fired - PF” ku një central i veçantë desulfurizimi duhet të arrijë të njëjtin kufi të emetimit. Rekomandohet të ndiqen hetime shtesë për të identifikuar metodën më ekonomike për desulfurizim. Koncepti i PF-së, është përllogaritur po ashtu për centralin 300 MW për qëllime krahasimi. Të dy proceset e djegies mund të arrijnë emetimet e duhura të nitrogjen oksidit (NO_x). Centrali i pastron gazrat e oxhakut prej pluhurit në elektrofiltra. Më pas, planifikohet që gazrat e oxhaqeve të dërgohen në kullën e madhe të ftohjes dhe të përzihen me avullin e ujit që del nga kulla, pra, eliminohet grumbulli më i madh. Centrali parashikohet të ketë një efikasitet të përgjithshëm prej 40 %. Në rast të aplikimit të teknologjisë djegëse të CFB për centralin 300 MW, efikasiteti i tij do të jetë 1-1.5 % më pak pasi do të mund të përdoren parametrat nën-kritike të avullit. Nuk ka referenca të dukshme për parametrat mbi-kritike me kazanët CFB. Shifrat e sakta të efikasitetit do të varen nga skicimi përfundimtar i centralit, duke marrë parasysh edhe ndikimin e mundshëm të Protokollit të Kiotos për Kosovën dhe investitorët. Është vlerësuar që vetë centrali do të punësojë drejtpërdrejt 200-300 persona në vënie në funksion gjatë fazës së parë, dhe ky numër do të dyfishohet gjatë fazës së dytë. Përveç kësaj, centrali do të shfrytëzojë shumë shërbime për mirëmbajtjen e vet. Vënia në funksion e shfrytëzimit minierar për centralin do të punësojë më shumë se 1,000 persona.

Performanca ekonomike dhe financiare

Centrali i ri termo-energjetik është vlerësuar se do të kushtojë 1.1-1.3 miliardë euro gjatë fazës së parë, plus kostot zhvilluese të minierës janë përllogaritur të arrijnë deri në 300 milionë euro. Faza e dytë është përafërsisht 10 % më pak e kushtueshme. Ndërtimi i dy njësive 300 MW në një central 600 MW gjatë fazës së dytë, do të kursente diku 15%. Kostoja operuese e centralit është përllogaritur të

arrijë 4euro/ton duke përdorur shpenzime të shfrytëzimit minerar direkt të linjtit dhe është paraqitur në tabelën 5.2.

Tabela 5.2 Kostoja e Operimit të Centralit

Lloji & Madhësia e Centralit	Shpenzimet Operative jo kapitale €/MWh	
300 MW CFB	10,26	
500 MW PF	10,46	
300 MW PF	10,72	
Në vlerësimin financiar janë supozuar këto të dhëna		
Interesi në mjete financiare	10,0	%
Çmimi i energjisë në treg	40	EUR/MWh
Norma e Tatimit	20,0 %	tatimi në fitim në Kosovë
Zhvleftësimi	5	% vjetore
Periudha e amortizimit	9,5	Vite
Rest value	20%	nga total investimi
Inflacioni	4	%
Racio Kredi/Ekuitet	70/30	
Kthimi në Ekuitet	20	% (minimumi i kërkuar)
Norma e Interesit (kredi)	10,0	%
Pagesa për Lignit	3,00	EUR/MWh
Dividenta	max ROE	(nga fitimi i mbajtur)

Centrali do të jetë fitimprurës me çmimin e supozuar të tregut, duke përdorur një prej opsioneve teknike. Centrali CFB dhe centrali i madh PF janë pothuajse të barabartë në përlogaritjet e vlerës aktuale neto - NPV, por më shumë avantazhe ka centrali PF. Riparimi i borxhit brenda 10 vjetësh prej fillimit të ndërtimit të çdo njësie, është i realizueshëm. Një analizë ndjeshmërie tregon se centrali do të ishte shumë fitimprurës po të përdorte ndonjë nga opsionet teknike nëse çmimi i shitjes së energjisë elektrike do të rritej deri në 60euro/MWh, dhe do të krijonte humbje (pas kostove të financimit, gjithashtu të gjithë opsionet teknike) nëse çmimi është 20euro/MWh. Për sa i përket përfitimeve ekonomike të ekonomisë kosovare nga centrali i ri, ndërtimi i minierës së re dhe centralit të ri energjetik, do të sjellë përafërsisht 60 milionë euro në vit nga paratë e huaja, gjatë 10 vjetëve të zhvillimit. Kur centrali i ri prej 2,000 MW është plotësisht i ndërtuar dhe është në veprim, xhiroja e tij do të jetë rreth 600 milionë euro (çmim shitjeje prej 40euro/MWh dhe 15 TWh/annum). Një e katërta, pra 25 % e atyre të ardhurave vjetore, mendohet të jetë direkt në dobi të ekonomisë kosovare, siç paraqitet në Tabelën 5.3.

Tabela 5.3 Përfitimet e drejtpërdrejta të ekonomisë Kosovare gjatë një tremujori të operimit të një centralit prej 2,000 MW

Artikulli	Shuma e vlerësuar €/vit
Pagat, miniera & centrale	25
Shërbimet e mirmbajtjes	25
Pagesa për hi & ujë	10
Pagesa e transferit të energjisë elektrike të TSO	30
Pagesa e lignitit	48
Toka me qira	2
Tatimi në fitim	10
Gjithsej për Kosovë:	150

Duhet theksuar gjithashtu se të ardhurat vjetore të centralit rrjedhin kryesisht nga shitjet e eksportit, pra fonde të reja në ekonominë kosovare. Kjo taksë është propozuar të jetë kriteri përzgjedhës për investitorët e ardhshëm. Duhet të fitojë oferta më e lartë (€ për ton). Vlerësohet që kjo shumë të jetë 3 euro për ton.

Rekomandime

Një nga veprimet më urgjente është të vazhdojë zhvillimi i minierës së Sibovcit, edhe pse investitorët e huaj do të duhet të vendosin vetë se kur dhe si do ta bëjnë atë. Koha që nevojitet për të zbratur tokën për ndërtim dhe për të zhvilluar minierën deri në pikën kur linjiti dërgohet në central, është me e gjatë sesa koha për gjenerimin e energjisë. Ri-rregullimi i zonës për zhvillimin e minierës përreth fshatit të Sibovcit, duhet të fillojë menjëherë. Depozitimi i hirit nga gjenerimi i energjisë ka nevojë për një zgjidhje të përhershme dhe të shëndetshme nga aspekti ambiental.

5.4 PERSPEKTIVAT E HC “ZHURI” - PRIZREN

Sistemi energjetik i Kosovës është jashtëzakonisht i zotëruar nga termocentralet. Do të ishte e dëshirueshme, veçanërisht nëse merret parasysh karakteri termal i sistemit energjetik të Kosovës, që të ndërtohej hidrocentrali i Zhurit. Vetëm një hidrocentral, HC Zhuri, është përzgjedhur si kandidat për t'u ndërtuar brenda periudhës afatgjatë të planit për zgjerimin e sistemit energjetik të Kosovës. Dy versionet e ndryshme të ndërtimit i janë nënshtruar analizave. Versioni i parë (HC Zhur 1) është konceptuar si projekt për dy centrale energjetike: Zhuri I dhe Zhuri II. Hapi bazë është HC Zhuri I me një fuqi nominale prej 246 MW, dhe kosto maksimale bruto prej përafërsisht 576 milionë euro.

5.5 CENTRALET E VOGLA ENERGETIKE

Ndërtimi i hidrocentraleve me shkallë të vogël hidrike, energjia e erës, gjeotermike, diellore, biomasa, dhe gazi nga përpunimi i mbeturinave urbane ose rurale, duhet të konsiderohen po ashtu si një perspektivë. Kanalet e vaditjes “Ibër Lepenci” dhe “Radoniqi”, janë identifikuar si vendndodhje ku është e mundur të ndërtohen hidrocentrale të vegjël. Studimi i para-zbatueshmërisë jep një përgjigje ndaj mundësive për të ndërtuar një zinxhir hidrocentralesh mbi lumin Lumbardhi i Pejës. Prioriteti i këtij sektori është krijimi i një kornize ligjore të përshtatshme dhe një tregu të favorshëm për promovimin e zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme në Kosovë. Qëllimi është krijimi i një ambienti miqësor për investime private në këtë sektor. Për zhvillimin hidrocentraleve të vegjël, duhet të hartohet kadastra e ujit dhe hidrocentraleve.

KAPITULLI 6 ZHVILLIMET RAJONALE DHE MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE

6.1 PREZANTIMI I PROCESIT TË ATHINËS– TRAKTATI I KEEJL

Krijimi i Komunitetit të Energjisë në EJL, është rezultat i të ashtuquajturit “Procesi i Athinës” për bashkëpunimin rajonal energjetik. Ky proces është iniciuar më 2002 nga Komisioni Evropian me mbështetjen e Paktit të Stabilitetit. Falë përkushtimit nga të gjitha palët e përfshira, është arritur progres i shpejtë përfshirë edhe nënshkrimin e një Memorandumi të Mirëkuptimit mbi Energjinë Elektrike në vitin 2002 në Athinë, si dhe zgjerimi i këtij bashkëpunimi në sektorin e gazit përmes Memorandumit të dytë të Mirëkuptimit të nënshkruar në dhjetor të vitit 2003. Bazuar në këto memorandume, vendet e EJL janë të përkushtuar që të fusin rregulla të përbashkëta bazuar në legjislacionin e “*acquis communautaire*” të BE-së në këta dy sektorë. Procesi ka marrë një përkrrahje të madhe përmes rikyçjes fizike të rrjeteve elektrike të EJL në rrjetin UCTE-së (Union for the Co-ordination of Transmission of Electricity) në tetor të 2004.

Përprjekjet e vendeve të EJL-së janë duke u mbështetur nga një grup i mirë-koordinuar donatorësh që udhëhiqen nga komisioni Evropian së bashku me bankën Botërore (BB), EBRD, IEA, EIB, USAID, CIDA (Kanada), Austrinë, Italinë, Francën, Gjermaninë, Republikën Çeke dhe Greqinë. Roli i Paktit të Stabilitetit ka qenë të plotësojë udhëheqjen e Komisionit Evropian duke gjeneruar mbështetje politike për këtë proces, midis qeverive të EJL dhe komunitetit ndërkombëtar, si dhe të promovojë këtë proces në komunitetin afarist.

Draft traktati është iniciuar më 22 mars 2005 nga delegatët e vendeve në Bruksel.

Nënshkrimi i Traktatit të KEEJL

Më 25 tetor 2005, në Athinë u nënshkrua traktati i parë shumëpalësh për Evropën Juglindore. Me anë të nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit Energjetik, Bashkimi Evropian dhe nëntë partnerët e EJL (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Serbia dhe Mali i Zi dhe në emër të Kosovës, UNMIK-u, si dhe Moldavia në statusin e Vëzhguesit) do të krijojnë kornizën ligjore për një treg të integruar të energjisë. Negociatat me Turqinë për futjen e saj në traktat në një stad më të vonë, janë në vazhdim e sipër. Presidenti i Komisionit Evropian, Jose Manuel Barroso përshëndeti Traktatin si “një arritje madhore për paqen dhe stabilitetin në Evropë”. Komisionari Andris Piebalgs i cili është përgjegjës për energjinë dhe ka nënshkruar traktatin në emër të Bashkimit Evropian, ka komentuar se “Traktati i Komunitetit të Energjisë do të rrisë sigurinë e furnizimit dhe do të japë mbështetje për një sektor që nga aspekti strategjik, është vital”.

Cilat do të jenë rezultatet e këtij Traktati?

Traktati synon të krijojë një kornizë rregullative të vetme dhe të qëndrueshme për tregtimin e energjisë përgjatë kufinjve, përmes sigurimit që miratimit të *acquis communautaire* të BE-së nga ana e vendeve të EJL, në fusha si energjia, ambienti dhe konkurrenca. Ndikimi ekonomik i kësaj do të jetë krijimi i një tregu energjetik më të madh, më të lëvizshëm dhe më të parashikueshëm, i cili do të jetë joshës për investitorët. Një treg modern, siguron një shesh lojërash të nivelizuar për të gjithë pjesëmarrësit dhe rrit besueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve energjetike. Ky traktat do të inkurajojë edhe zhvillimin e tregut të gazit i cili është në zhvillim e sipër në rajon, dhe do të sigurojë mundësi më të mëdha për forcën punuese të aftësuar në rajon. Puna përgatitore përfshirë identifikimin e projekteve të rehabilitimit dhe investimeve, duhet të lehtësojnë investimet nga sektori privat dhe ai publik pasi industria është ristrukturuar dhe kanë dalë në sipërfaqe mundësitë për të ndërtuar dhe vënë në funksion centrale të reja energjetike ose për të menaxhuar kompanitë e shpërndarjes. BB tashmë ka vendosur për një hua “të përshpejtuar” (fast track) prej 1 bilion dollarësh për t’i ndihmuar investimet nëpër gjithë rajonin. Domethënia politike e këtij traktati nuk duhet të nënvlerësohet. Vendet e EJL kanë bërë formal përkushtimin e tyre ndaj bashkëpunimit rajonal në sektorin energjetik duke përfshirë edhe sigurimin e ndihmës së përbashkët përmes këtij traktati që i detyron palët në nivel ndërkombëtar. Zbatimi do të ketë si rezultat futjen e vendeve të EJL në tregun e brendshëm të BE-së në një sektor ekonomik kyç, përpara hyrjes së tyre në BE. Shumë vetë e kanë krahasuar këtë traktat me Traktatin e Komunitetit Evropian për Qymyr dhe Çelik të krijuar më 1951, traktat i cili shtroi rrugën drejt Komunitetit Evropian.

Nevojat për Investim

Një studim i fundit që është bërë nga Komisioni Evropian (KE) dhe nga BB, vlerëson se gjatë 15 viteve të ardhshme, do të nevojiten **12.5 miliardë** euro për rehabilitimin e centraleve ekzistues dhe ndërtimin e të rinjve, edhe kjo shifër është përveç 8.5 miliardë eurove të nevojshme për investimet në transmetim dhe shpërndarje.

Objektivat e Traktatit

- Të krijojë një kornizë të vetme dhe të qëndrueshme rregullative dhe të tregut nëpër gjithë Evropën; kjo duhet të rrisë joshjen e EJL për investime në sektorin energjetik;
- Të rrisë sigurinë e furnizimit;
- Të përmirësojë situatën ambientale; dhe
- Të zhvillojë konkurrencën në një shkallë më të gjerë gjeografike dhe të shfrytëzojë ekonomitë në masë të gjerë.

Më praktikisht, aktivitetet e Komunitetit të Energjisë do të përfshijnë:

- Zbatimin e “acquis communautaire” të BE-së;
- Krijimin e një mekanizmi të vetëm për transmetimin ndërkufitar dhe/ose operimin e tregjeve të energjisë; dhe
- Krijimin e një tregu energjetik pa kufinj të brendshëm.

Traktati i Komunitetit të Energjisë përcakton institucionet vijuese sipas Titullit V:

- Këshilli Ministror (KM);
- Grupi Permanent i Nivelit të Lartë (GPNL);
- Bordi i Rregullatorit
- Forumi; “Forum i Athinës” për energjinë elektrike dhe “Forum i Stambollit” për gaz
- Sekretariati (ECS)

Pjesëmarrja e ZRRE-së në takimet dhe forumet e SEEREM:

Këshilli i Rregullatorëve Evropianë të Energjisë (KREE-CEER) ka themeluar Grupin Punues të Rregullimit të Energjisë për EJL (SEEER WG) ku janë krijuar Task Forca dhe ku ZRRE-ja ka caktuar anëtarë të stafit të vet në çdo Task Forcë të këtij GP.

Takimet e SEEER WG – Pjesëmarrja e ZRRE-së:

Takimi i 10 i SEEER WG (Romë, 4 shkurt 2005);

Takimi i 11 SEEER WG (Sofje, 20 maj 2005);

Takimi i 12 i SEEER WG (Shkup, 09 qershor 2005);

Takimi i 13 i SEEER WG (Beograd, 23 nëntor 2005);

Stafi i ZRRE-së është përfshirë në komentimin e dokumenteve dhe në shprehjen e kërkesave për anëtarësi aktive të Kosovës në Task Forcën e SETSO-s. Pas takimit të 11 të SEEER WG ku përfaqësuesit e ZRRE-së paraqitën një letër të nënshkruar prej PSSP-së, Komiteti Drejtues i ETSO-s dhe KE-ja kanë rënë dakord të lejojnë ZRRE-në të marrë pjesë në Task Forcën e SETSO-s për të përfaqësuar Sistemin e Transmetimit të Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut.

ZRRE-ja ka marrë pjesë në Forumin Rajonal, dy Javët e Energjisë (Shkup, 6-10 qershor 2005), (Beograd, 24-25 nëntor 2005) dhe në “mini-Forum” e parë të EJL (Athinë, 6-7 tetor 2005).

ZRRE gjithashtu ka marrë pjesë në:

Takimin e parë të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (BRKE– Athinë, shkurt 2005); dhe Takimin e parë të Grupit Rregullator të KEEJL për Gaz (Zagreb, Kroaci, 30 shtator 2005)

6.2 MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2005, ZRRE-ja ka forcuar dhe përmirësuar marrëdhëniet me institucionet e brendshme të sektorit të energjisë (UNMIK, IPVQ, etj.), dhe me organizmat dhe Shoqatat e huaja rajonale

Parlamenti i Kosovës

Parlamenti i Kosovës ka shtyrë për më shumë se një vit emërimin e dy Anëtarëve të Bordit të ZRRE-së (së fundi ata janë emëruar në Shkurt të vitit 2006). ZRRE-ja ka dorëzuar Raportin Vjetor Parlamentit në muajin maj të vitit 2005. Stafit i ZRRE-së ka qenë i kyçur në grupet punuese të Parlamentit për zhvillimin e legjislacionit primar (Ligjit për Ngrohje Qendrore).

UNMIK/Shtylla e BE-së

Kryesuesi i ZRRE-së rregullisht ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga Shtylla e IV e BE-së, duke shprehur brengat dhe duke mbrojtur nevojën për një rregullator të fuqishëm dhe të pavarur. Raportet mujore të ZRRE-së i janë dërguar ZPSSP-së, shtyllës së IV të Be-së dhe AKM-së etj.

Të gjitha raportet e marra nga Shtylla e IV janë plotësuar nga stafi i ZRRE-së dhe janë kthyer pa asnjë vonesë.

ZPSSP-ja Z. Joachim Ruecker, ka vizituar ndërtesën dhe stafin e ZRRE-së me 17 mars 2005. ai me këtë rast është informuar me aktivitetet e ZRRE-së dhe çështjet e tjera në sektorin e energjisë në Kosovë.

UNMIK/AKM

AKM-ja është përgjegjëse për menaxhimin e ndërmarrjeve të energjisë të Kosovës (KEK-un dhe kompanitë e ngrohjes qendrore). ZRRE-ja së bashku me të gjitha palët e tjera të kyçura në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në proceset e ndërlidhura me korporatizimin e ndërmarrjeve të energjisë dhe proceset tenderuese për importin e energjisë elektrike.

Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM)

Së bashku me stafin e MEM-it dhe me Ministrin Z. Et'hem Çeku janë mbajtur takime të rregullta, konsultime, punëtori, dhe seminare ku çështjet kryesore që janë prekur në këto takime kanë qenë:

- Strategjia për Energji e Kosovës (e aprovuar nga Parlamenti i Kosovës)
- Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike dhe Themelimi i OPSTT-së
- Draft Ligji për Efikasitetin e Energjisë
- Strategjia e investimeve, prioritetet
- Bilanci i Energjisë
- Energjia e Ripërtëritshme
- Përkrahja për KEK-un për planin e strategjisë për Rimëkëmbje

Donatorët

Donatorët janë AER, BB, USAID, KfW, BMZ, Sida, dhe Investitorët e huaj. ZRRE-ja ka pasur përfitim të drejtpërdrejt të projekteve për Asistencë Teknike nga AER, USAID, Sida, dhe KfW-ja. Stafit i ZRRE-së ka marrë pjesë në komisionet drejtuese të BB-së për projektet ESTAP II dhe ESTAP III. ZRRE-ja ka bërë disa prezantime për situatën e tanishme të sektorit të energjisë dhe kornizës ligjore të Kosovës, duke pasur për qëllim të njoftoi donatorët dhe Investitorët e Huaj për nevojat dhe prioritetet e investimeve në sektorin e energjisë.

KEK-u

ZRRE-ja ka mbajtur takime të rregullta me KEK/ESBI dhe me stafin kyç. Çështjet e diskutuara në këto takime kanë qenë: Politika e Furnizimit me Energji; Përshtatja e procedurave të zhvilluara nga KEK-u me rregulloret e aplikueshme; Bilanci i Energjisë; Përkrahja e Strategjisë për Inkasim të KEK-ut; Standardet e Kualitetit; Strategjia e Energjisë Elektrike për sezonin e dimrit; Politika e Shkryçjes; Politika ABC, dhe Ankesat e Konsumatorëve.

Stafit i KEK-ut është ftuar të marrë pjesë në të gjitha punëtorit dhe seminarët e organizuara nga projektet e konsulentëve të Asistencës Teknike si projekte të dedikuara për ZRRE-në dedikuar sektorit të energjisë elektrike.

Kompanitë e Ngrohjes Qendrore

ZRRE-ja ka mbajtur takime të rregullta me stafin kyç dhe atë menaxhues të kompanive të NQ-së. Fokusimi kryesor në këto takime ka qenë Ligji për Ngrohje Qendrore dhe çështjet e tarifave.

Në takimin e Përgjithshëm të Asamblesë të ERRA-s të mbajtur me 13 Prill, 2005 në Budapest të Hungarisë ZRRE-ja është bërë Pjesëtare e Anëtarësuar e ERRA-s. Deri më sot në listën e ERRA-s janë 23 Anëtarë të Plotë dhe 5 të Anëtarësuar. Shoqata është e regjistruar ligjërisht në Hungari në prill të vitit 2001 dhe sekretariati i sajë operon në Budapest.

Objektiv kryesor i Shoqatës është që të rrisë shkëmbimin e informatave dhe eksperiencave në mes të anëtarëve dhe të zgjeroi qasjen në eksperiencat rregullative nëpër botë.

Si Anëtare e ERRA-s, ZRRE-ja në mënyrë aktive ka marrë pjesë në aktivitetet e ERRA-s:

- Ka përgatitur dhe ka dërguar informacione/dosje në ERRA
- Ka caktuar anëtarë në të gjithë komitetet dhe Grupet punuese të ERRA-s
- Ka marrë pjesë në Takimet/Konferencat/Trajnimet vijuese të organizuara nga ERRA/NARUC:
 - a) Konferenca e Rregullatorëve të Energjisë për Rregullimin e Energjisë dhe Investimeve (11-12 prill, Budapest, Hungari)
 - b) Konferenca vjetore e ERRA-s (13-14 prill, Budapest, Hungari)
 - c) Programi i tretë Ndërkombëtar për Trajnimin mbi Praktikën e Rregullimit të Energjisë; ERRA – së bashku me Universitetin e Evropës Qendrore (CEU) (16-23 korrik, Budapest, Hungari)
 - d) Takimi për Komitetin Licencues/Konkurrencës (5-6 shtator, Shën Pjetërburg, Rusi)
 - e) Takimi për Komitetin për Tarifa/Çmim-vënie (22-23 shtator, Jerevan, Armeni)
 - f) Takimi i Grupit Punues të rregullimit Ligjor (24-25 tetor, Kiev, Ukrainë)
 - g) Workshop për Pjesëmarrjen dhe Komunikimin e Rregullatorëve (26-27 tetor, Kiev, Ukrainë)
 - h) Kursi pilot i të mësuarit elektronik mbi Rregullimin e Energjisë (24 tetor–5 dhjetor)

KAPITULLI 7 PASQYRA E AKTIVITETEVE TJERA TË ZRRE

7.1 AKTIVITETET KRYESORE TË ZRRE NË VITIN 2005

- Përgatitja e Legjislacionit Dytësor (rregullat) definuar si në Ligjet e Sektorit të Energjisë
- Përgatitja e modelit të Tregut të Ardhshëm të Energjisë Elektrike, Rregullave të Tregut, Metodologjisë së Tarifave
- Pjesëmarrja në aktivitetet e lidhura me Strategjinë Energjetike të Kosovës
- Pjesëmarrja në studimet investitore për investime të reja dhe për rehabilitimin e TPP të Kosovës
- Pjesëmarrja në procesin për inkorporatizimit e KEK-ut dhe Kompanive të NQ
- Pjesëmarrja për Operatorit të Pavarur të Sistemit Transmetimit të Tregut ITSMO (Projektet mbështetëse nga BB dhe AER)
- Pjesëmarrja në aktivitetet për mbështetjen e KEK-ut rreth Strategjisë së tyre të Ardhurave
- Pjesëmarrja në aktivitetet për efikasitetin e energjisë dhe energjinë e përtërirë
- Pjesëmarrja në aktivitetet e Marrëveshjes ECSEE
- Pjesëmarrja në aktivitetet e ERRA-s

7.2 VIZITAT DHE KONFERENCAT

Veç pjesëmarrjes në aktivitete të organizuara me Marrëveshjen ECSEE dhe ERRA, stafi i ZRRE ka marrë pjesë edhe në këto konferenca/takime/workshope/seminare/trajtime:

- **Seminari Rajonal i Evropës Jug-lindore EBRD** (Tiranë Shqipëri, 10-11 shkurt 2005); Banka Evropiane për Zhvillim Rajonal BEZHR ka organizuar seminar për pjesëmarrësit e SEE; Një analist nga ZRRE për monitorimin e tregut mori pjesë në këtë seminar.
- **ETSO Workshopi mbi Sigurinë e Furnizimit në tregun e Liberalizuar të Energjisë** (Bruksel, Belgjikë, 15 mars 2005); Dy anëtarë të Bordit të ZRRE morën pjesë në këtë workshop.
- **Seminar i hapur në Tregjet Rajonale për Energjinë e Përtërirë** (Lisbonë, Portugali, 17-18 mars 2005); Kryesuesi i Departamentit Ligjor dhe të Licencave – anëtar i Bordit të ZRRE ishte pjesëmarrës në këtë seminar.
- **Trajnim interaktive në Entin e Rregullatorit të Energjisë të Shqipërisë - ERE** (Tiranë, Shqipëri, 12-13 maj 2005); Stafi i DMK dhe Analisti i Strukturës së Tarifave të ZRRE-së patën trajnim dy ditor në ERE të Shqipërisë.
- **Konferencë Ndërkombëtare: Roli i koo-gjenerimit në SEE** (Selanik, Greqi, 12-13 maj 2005); eksperti I NQ I ZRRE mori pjesë në këtë konferencë organizuar nga Shoqata helene për koo-gjenerim të Ngrohjes dhe Energjisë (HACHP)
- **Takim: KEK, AKM, ZRRE – EPS (Serbi)** (Shkup, 26 maj 2005); diskutuan për CBT dhe shërbimet ndihmëse midis KEK-ut dhe EPS.
- **Mbledhja e Komitetit Drejtues për Studimin e Fizibilitetit për Linjën Interkonektuese 400 kV Kosovë – Shqipëri** (Tiranë Shqipëri, 31 gusht – 1 Shtator); Eksperti për Sistemin e Energjisë – Anëtar i Bordit të ZRRE-së përfaqësoi ZRRE në këtë takim SC të projektit të BB.
- **Konferenca për Financimin e investimeve të kapaciteteve të reja prodhuese në Evropën juglindore** (Sofje, Bullgari, 14-15 shtator 2005); Kryesuesi i ZRRE mori pjesë në këtë konferencë.
- **Takim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë të Bullgarisë** (Sofje, Bullgari, 14 shtator 2005); Kryesuesi i ZRRE bashkë me Ministrin e MEM dhe DSRSG patën takim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë të Bullgarisë.
- **Konferenca e Pestë Ballkanike mbi Energjinë** (Sofje, 14-16 shtator 2005); Eksperti për Energi – anëtar i Bordit të ZRRE ishte prezent në këtë konferencë.

- **Trajnimi për Energji të qëndrueshme dhe teknologjitë e thëngjillit të pastër** (SHBA, 4-26 nëntor); Analist i Monitorimit të Tregut i ZRRE-së mori pjesë si përfaqësues i ZRRE-së në këtë trajnim financiar nga Zyra Amerikane në Prishtinë.
- **IEE Konferenca për Tregtim të Energjisë** (Londër, 21-22 nëntor); Kryesuesi i ZRRE dhe Kryesuesi i Departamentit Ligjor dhe të Licencave – anëtare e Bordit ishin prezentë në këtë konferencë.
- **Vizitë nga Autoriteti Rregullator i Energjisë (ARE) i Shqipërisë** (Prishtinë, 19-20 dhjetor); ZRRE priti zyrtarët e ARE nga Shqipëria, qëllimi kryesor i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit ndër-rajonat dhe këmbimi i përvojave lidhur me çështjet rregullative; një delegacion 6 anëtarësh i ARE udhëhequr nga Kryesuesi i Zyrës patën një takim të përbashkët me ZRRE, me KEK-un/ESBI-n, dhe vizituan TC Kosova B, dhe patën takim edhe me MEM-in.

KAPITULLI 8 NGROHJA QENDRORE

8.1 PËRSHKRIMI SHKURTËR I SEKTORIT TË NGROHJES QENDRORE NË KOSOVË

Spektori i Ngrohjes Qendrore në Kosovë është i kufizuar në katër ndërmarrje të vogla komunale të cilat mbulojnë komunat e Prishtinës, Gjakovës, Mitrovicës dhe Zveçanit. Ngrohja Qendrore në Kosovë ekskluzivisht përdoret për ngrohjen e sipërfaqeve dhe nuk përfshin furnizimin me ujë të ngrohtë sanitar. Si pasojë, pjesa e tregut në relacion me kërkesën e vlerësuar për ngrohje në Kosovë është shumë e vogël, dhe në këtë mënyrë diku plotëson rreth 5% të kërkesës të tërësishme për ngrohje. Sistemet e ngrohjes qendrore në Prishtinë dhe Gjakovë veprojnë respektivisht përmes kompanive të integruara vertikalisht Termokos dhe NQ Gjakova. Termokos dhe NQ Gjakova janë Ndërmarrje Publikisht Vetanake (POE), me asete nën përkujdesjen (besimin) e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM). Kohëve të fundit Projekti i inkorporatizimit ishte plotësuar për Termokos-in dhe NQ Gjakova, sipas të cilit këto dy kompani janë transformuar në Shoqëri të Bashkuara Aksionare. Sistemi i Ngrohjes Qendrore në Mitrovicë operon përmes Termomit-it, i cili është “Njësi Punuese” e kompanisë së Ndërmarrjes Komunale të integruar Standard. Në mënyrë të ngjashme, sistemi i ngrohjes qendrore në Zveçan operon nga ndërmarrja komunale e integruar dhe kompania e ndërtimeve “Zveçan”.

Prodhimi i ngrohjes

Prodhimi i ngrohjes kryhet në ngrohjtore të pajisura me kaldaja që përdorin lëndët djegëse mazut dhe dizel D2 në sasi më të vogël.

Kapacitet prodhuese të ngrohjes të Termokos-it përbëhen nga ngrohjtoria me kapacitet të instaluar furnizimi prej 116 MW – dy kaldaja që djegin mazut me 58MW secili, dhe kapaciteti i instaluar rezervë – njëra kaldajë me kapacitet prej 29 MW; dhe dy kaldaja në qendrën spitalore me kapacitet të përgjithshëm prej 14 MW (secila kaldaj ka 7 MW).

Ndërmarrja për prodhimin e ngrohjes NQ Gjakova ka dy kaldaja me kapacitet prej 20 MW dhe 18.6 MW, që jep një kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 38.6 MW.

Aftësitë prodhuese të ngrohjes përbëhen nga ngrohjtoria “Lisic Polje” e pajisur me vetëm një kaldajë me kapacitet nominal prej 9.3 MW, dhe ngrohjtoria në spital që ka tre kaldaja operuese shumë të vogla me kapacitet të përgjithshëm prej 7.6 MW.

Prodhimi i ngrohjes në Zveçan kryhet nga ngrohjtoria e pajisur me dy kaldaja me kapacitet prej 800 kW secila.

Rrjeti i distribuimit

Rrjeti i distribuimit mbulon pjesët e qytetit me dendësi më të madhe të popullatës / blloqet e ndërtesave shumë katëshe. Rrjeti i distribuimit përbëhet nga rrjeti primar deri te pika e furnizimit në nënstacion dhe rrjeti sekondar nga pika e furnizimit deri në trupin (pajisjen) grohës të përdoruesi i fundit i ngrohjes.

Rrjeti i distribuimit i ngrohjes qendrore Termokos ka rreth 28 km të gjatësisë së vijës së gypave primare. Rrjeti i shpërndarjes është dizajnuar ashtu që kapaciteti i tij i distribuimit është përafërsisht 300 MW. Pjesa integrale e rrjetit të distribuimit është stacioni i pompit dhe i shkëmbimit të ngrohjes të vendosura në bregun e diellit dhe 243 nënstacionet që janë pika ndarëse midis rrjetit primar dhe rrjetit sekondar.

Rrjeti i distribuimit i NQ Gjakova përbëhet nga 12 km të kanalit të gypave në përgjithësi, 4 km të kanalit të gypave të cilat janë konstruktuar në vitin 2001, dhe rreth 62 nënstacione si pjesë e rrjetit që ndan rrjetin primar dhe atë sekondar. Njehsorët e ngrohjes janë instaluar në 42 nënstacione.

Rrjeti i shpërndarjes i Termomit-it përbëhet nga dy pjesë të ndara. Pjesa kryesore e rrjetit është e lidhur me ngrohjtoren “Lisic Polje”, derisa tjetra është e lidhur me ngrohjtoren në pronat e spitalit. Gjatësia e përgjithshme e kanalit të gypave është rreth 4.5 km.

Tabela në vijim jep një përmbledhje të karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore, prodhimin të ngrohjes dhe të dhënave të furnizimit.

Tabela 8.1 Karakteristikat teknike të Sistemeve të Ngrohjes Qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW]	Rrjeti i Distribucionit		Ngrohja e gjeneruar [MWh / year]				Ngrohja e dhënë te nënstacioni i konsumatorëve			
		Line Length [km]	No. Substations	2001 /02	2002 /03	2003 /04	2004 /05	2001 /02	2002 /03	2003 /04	2004/05
TERMOKOS (Prishtina)	2 x 58 = 116 1 x 29 = 29 2 x 7 = 14	28.5	243	83,174	71,585	96,790	102,932	62,380	53,689	72,593	97,467
Gjithsej	159	28.5	243	83,174	71,585	96,790	102,932	62,380	53,689	72,593	97,467
KNQ Gjakova (Gjakova)	1 x 20.0 = 20.0 1 x 18.6 = 18.6	12	62	16,530	17,901	18,274	16,289	13,224	14,321	14,619	13,053
Gjithsej	38.6	12	62	16,530	17,901	18,274	16,289	13,224	14,321	14,619	13,053
TERMOMIT (Mitrovica)	1 x 9.3 = 9.3 2 x 3.3 = 6.6 1 x 1.0 = 1.0	4.5	20	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Gjithsej	16.9	4.5	20	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
KNQ Zveçan	2 x 0.8 = 1.6	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Gjithsej	1.6	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA

NA: Nuk janë në dispozicion

Çështjet lidhur me konsumatorët

Shërbimi i furnizimit

Hapësira aktuale e shërbimit të furnizimit e mbuluar nga Termokos-i, për të dy grupet e konsumatorëve – grupit të konsumatorëve shtëpiak dhe grupit të konsumatorëve komercialë e institucional, është rreth 1,035,000 m² përkatësisht 617,000 m² dhe 418,000 m². Termokosi furnizon rreth 12,100 konsumatorë gjithsej – 11,540 shtëpiak (Amvisni), dhe 560 konsumatorë komercialë dhe institucional.

Hapësira e përafërt e shërbimit të furnizimit e NQ Gjakova është 134,000 m². Raporti midis grupit të konsumatorëve shtëpiak dhe grupit të konsumatorëve komercialë e institucional është përafërsisht në proporcion me 45 % me 55%.

Hapësira e shërbimit të furnizimit i Termomit-it mbulon të dy grupet e konsumatorëve, shtëpiak (Amvisni) dhe komercial e institucional. Për shkak të kushteve të këqija të rrjetit dhe sistemeve sekondare, konsumatorët shtëpiak (Amvisnit) nuk janë furnizuar gjatë sezonit të fundit. Hapësira e shërbimit të furnizimit për grupin e konsumatorëve komercialë dhe institucional është vlerësuar diku në rreth 27,100 m².

Hapësira furnizuese e Zveçanit përfshin vetëm grupin e konsumatorëve komercialë dhe institucionalë dhe është vlerësuar diku në rreth 8,900 m².

Faturimi dhe mbledhja e pagesave

Për shkak të mos-implementimit të njehsimit të ngrohjes, faturimi është realizuar në relacion me hapësirën ngrohëse të secilit konsumator. Janë vërejtur vështirësi lidhur me faturimin në kuptimin e mosarritjes së faturimit të planifikuar për shkak të zbritjes së ditëve me ngrohje shkaktuar nga prishjet në sistem (ngrohësja, rrjeti), shkalla akoma e lartë e rrjedhjes së ujit (në sezonin e ngrohjes 2004/2005 vlerësohet rreth 250m³/ditë) dhe një bazë jo të sigurt e të dhënave të konsumatorëve.

Nivel mesatar i arkëtimit të pagesave për sezonin e ngrohjes 2004/2005 është përafërsisht në nivel rreth 35 % për shkak të një sërë faktorësh të ndryshëm. Disa prej tyre janë drejtpërdrejt të lidhur me ndërmarrjen e ngrohjes qendrore siç është gjenerimi dhe realizimi i furnizimit, shërbimi i konsumatorëve, dhe mos efikasiteti i faturimit dhe mbledhjes. Faktorët tjerë janë të lidhur me situatën e tërësishme ekonomike dhe të ardhurave të popullsisë siç janë mundësia dhe dëshira për të paguar, mungesa e administrimit të ndërtesave, dhe masat jo të sigurta ligjore në marrjen me çështje të mospagesës nga konsumatorët.

Tabela 8.2 Shkalla e inkasimit në ndërmarrjet e NQ në Kosovë për sezonin e ngrohjes 2004/2005

Sezona e Ngrhjes 2004/2005	Hapsira Ngrhëse	Tarifa [€ / m ²]	Faturimi [€]	Inkasimi [€]	Norma e Inkasimit %
Termokos Prishtina					
Amvisri	616,441	0.85	2,031,392	286,743	14.12
Komercial & Publik	418,695	1.1	1,869,380	1,199,212	64.15
Total	1,035,136		3,900,772	1,485,955	38.1
KNQ - Gjakova					
Amvisri	53,911	0.82	241,063	51,289	21.28
Komercial & Publik	57,367	1.25	413,085	152,410	36.9
Total	111,278	-	654,148	203,699	31.14
Termomit - Mitrovica					
Amvisri	0				
Komercial & Publik	27,100	1.2	NA	NA	NA

NA: Nuk janë në dispozicion

8.2 KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR SHQYRTIMIN E ÇMIMEVE TË NGROHJES QENDRORE

Në përputhje me legjislacionin primar – Nenet 46, 47, 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja është përgjegjëse për vendosjen e metodologjisë së tarifave dhe për aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë. Këtu janë një sërë parimesh të gjera që thërrasin për parime të arsyeshme, të justifikuar dhe jo diskriminuese sipas të cilave ndërmarrjet energjetike duhet t'i rikthejnë të gjitha kostot e justifikuar duke përfshirë kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre.

Sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë në transmetim dhe në distribuim të ngrohjes kualifikohet si monopol natyror, përdërisa tash për tash nuk ekziston ndonjë konkurrencë në prodhimin e ngrohjes. Prandaj tarifat për ngrohjen qendrore janë subjekt aprovimi nga ZRRE.

Në përputhje me obligimet dhe kompetencat e veta, ZRRE ka bërë shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2005/2006. Me qëllim që të kemi një proces kuptimplotë të procesit të shqyrtimit të çmimeve dhe për të aplikuar parimet bazë se tarifat e ndërmarrjeve publike duhet të jenë të bazuara në kostot, ZRRE ka adoptuar qasjen e fokusuar në vlerësimin real informatës teknike dhe financiare të dhënë nga Ndërmarrjet e Ngrhjes Qendrore.

ZRRE me kohë ka filluar përgatitjen e saj për shqyrtimin e çmimeve duke draftuar dhe nxjerrë dy udhëzime:

- Udhëzimin e përkohshëm I_01_2005 mbi Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrhjes Qendrore, nxjerrë më 30 qershor 2005, në të cilin anë përcaktuar procedurat për dorëzimin e raporteve rregullative, dhe përmbajtjen e raportimit rregullativ për sezonin e ngrohjes qendrore 2004-2005.
- Udhëzimin e përkohshëm I_02_2005 mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrhjes Qendrore në Kosovë për sezonin e ngrohjes 2005/2006 nxjerrë më 10 gusht 2005, në të cilin janë përcaktuar procedurat për dorëzimin dhe aprovimin e tarifave, dhe cakton metodologjinë për llogaritjen e tarifave.

Përmbajtja e Udhëzimeve

Udhëzim I_01_2005 mbi Raportimin Rregullativ përmbajnë shpjegim të detajuar të përmbajtjes së informatës që duhet dorëzuar gjatë raportimit rregullativ në sezonin 2004-2005, dhe afatet e fundit për dorëzim. Ai gjithashtu përmban udhëzime të detajuara për plotësimin pasqyrave rregullative. Aneksat e Udhëzimit – Aneksi 1: Pasqyrat Rregullative; dhe Aneksi 2: Tabela e rishikimit periodik të Ndërmarrjeve të Ngrhjes Qendrore.

Në Udhëzimin I_02_2005, janë dhënë në detaje procedurat për dorëzimin e aplikacionit për tarifa dhe aprovimin e tarifave për sezonin e ngrohjes qendrore 2005-2006, si dhe metodologjia e tarifave. Si shtesë, Udhëzimi I_02_2005 gjithashtu përmban: Aneksin 1 – Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) mbi Bazën e Rregulluar të Aseteve (BRrA); dhe Aneksin 2 – Detajet për llogaritjen e Tarifës.

Metodologjia e Tarifave

Për qëllime të formulimit/llogaritjes së tarifave dhe çmimeve, është aplikuar metodologjia e Normës së Kthimit (NeK) (apo e quajtura kosto plus). Metodologjia NeK definon koston e lejuar që duhet të rikthehet dhe të fitohet një profit i arsyeshëm nga Ndërmarrja e Ngrohjes Qendrore, e cila është llogaritur sipas Normës së lejuar të Kthimit në Bazën e Rregulluar të Aseteve (BRrA).

8.3 SHQYRTIMI I ÇMIMEVE PËR SEZONIN E NGROHJES QËNDRORE 2005-2006

Me qëllim të arritjes së një progresi të kënaqshëm të shqyrtimit të çmimeve, ZRRE ka filluar procesin e shqyrtimit të çmimeve duke organizuar takime informative apo forma tjera ndër-veprimi me ndërmarrjet e ngrohjes qendrore dhe palë tjera relevante me qëllim që të shpjegohen dhe sqaron Udhëzimet dhe aspektet kryesore të procesit të shqyrtimit të çmimeve.

Shqyrtimi i çmimeve për sezonin 2005 /2006 ka përfshirë gjithë sektorin e NQ të Kosovës – NNQ Termokos, Prishtinë; NNQ Gjakova, NKP Standard / NNQ Termomit, dhe NNQ e NKP Zveçan. Në përputhje me procedurat të përcaktuara në udhëzimet e lartpërmendura procesi I shqyrtimit të çmimeve filloi nga Ndërmarrjet e NQ duke dorëzuar te ZRRE-ja raportet rregullative dhe pakon e aplikimit për tarifa. Duhet përmendur se edhe pse raportimi rregullativ dhe aplikacionet ishin më të kompletuara se në vitin e kaluar, ZRRE sërish është ballafaquar me vështirësi siç janë: vonesa në dorëzim, mos-besueshmëria dhe mos-kompletimi i informatave dhe të dhënave të kërkuara, si dhe dokumenteve mbështetëse.

Procesi i vendosjes së tarifave dhe aprovimit të tyre ishte i bërë në dy hapa:

1. Përcaktimi i të ardhurave të lejuara, bazuar në : informatën dhe të dhënat e parashikuara në aplikacionin për tarifa; ii) informatën e paraqitur në raportimin rregullativ, si psh. Të dhënat financiare, teknike dhe të konsumatorëve që aktualisht janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2004/2005; iii) bashkërendimi i tarifave aktuale dhe atyre të projektuara, që është bazuar në dallimin midis të ardhurave të planifikuara dhe atyre aktuale të sezonit të kaluar të ngrohjes.
2. Llogaritja e tarifave bazuar në të ardhurat e lejuara të përcaktuara dhe në propozimin për tarifa, i cili ishte subjekt aprovimi nga ZRRE-ja.

ZRRE nxori të ardhurat e lejuara të përcaktuara për secilën ndërmarrje të NQ, i cili ishte shoqëruar me një raport rregullativ gjithëpërfshirës dhe të detajuar si Aneks për përcaktimin e të ardhurave të lejuara. Raporti rregullativ përfshin këto pjesë kryesore:

- Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë së Tarifave NeK, ku janë prezantuar në mënyrë specifike parimet bazë të metodologjisë, një formulim që konsiston në llogaritjen skematike të të ardhurave të lejuara, si dhe jep formulat rregullative bazë.
- Përcaktimi i të ardhurave të lejuara kryesisht ka përfshirë si vijon:
 1. Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operationale të lejuara të cilat kanë përmbajtur shpjegim analitik dhe justifikim për përcaktimin e vlerës së lejuar për çdo grupi kostosh dhe për gati të gjitha pozicionet kryesore që e përbëjnë një grupe të veçantë kostosh.
 2. Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit
 3. Përcaktimin e Kthimit të lejuar mbi Bazën e Rregulluar të Aseteve (BRrA), i cili përfshin:
 - i) vendosjen e BRrA-së; dhe
 - ii) llogaritjen e “WACC” dhe profitit të lejuar.
 4. Bashkërendimin e tarifës aktuale, bazuar në dallimin midis të ardhurave të planifikuara dhe atyre aktuale në sezonin e kaluar të ngrohjes.

Përcaktimi i të ardhurave të lejuara është bazë për llogaritjen finale të tarifave dhe dorëzimin e propozimit për tarifa nga ndërmarrjet e NQ të ZRRE-ja për aprovim final.

Si pasojë e procesit të përshkruar më lart, ZRRE ka konkluduar rishikimin e çmimeve duke nxjerrë vendime përkatëse për aprovimin e tarifave për secilën ndërmarrje të NQ – që do të thotë:

1. Vendimi D_04_2005 i nxjerrë më 5/11/2005 mbi aprovimin e tarifave për NNQ Gjakovë;
2. Vendimi D_05_2005 i nxjerrë më 17/11/2005 mbi aprovimin e tarifave për NNQ Termokos;
3. Vendimi D_06_2005 i nxjerrë më 30/11/2005 mbi aprovimin e tarifave për NKP Standard / NjNQ Termomit Mitrovicë; dhe
4. Vendimi D_07_2005 i nxjerrë më 05/12/2005 mbi aprovimin e normës së tarifave për NKP Zveçan.

Më poshtë është prezantuar tabela e normës së tarifave duke përfshirë në vendimin përkatës për TERMOKOS-in.

Tabela 8.3

TARIFAT PËR KOMPANIË E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS" PËR SEZONËE NGROHJES 2005/2006

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT TË PA-NJEHËSUAR

KOMPANIA E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS"		
Komponentet e Tarifës	Amvisri	Komerical & Institucional
Kapaciteti i Kontraktuar për Ngrohje (komponenta fikse)	0.17 € / m2 për muaj	0.20 € / m2 për muaj
Ngrohja e dhënë (komponenta variabile)	0.63 € / m2 për muaj	0.76 € / m2 për muaj

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHËSUAR

KOMPANIA E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS"	
Tarifa Mujore e kapacitetit për ngrohje (komponenta fikse)	1.55 € / kW
Tarifa e Ngrohjes së dhënë (komponenta variabile)	36.07 € / MWh

Më poshtë është prezantuar tabela përmbledhëse e tarifave të ngrohjes qendrore për katër kompanitë e ngrohjes qendrore në Kosovë

Tabela 8.4 Tabela e përmbledhur e tarifave për konsumatorët e njehsuar dhe ata të pa njehsuar – Sezoni i NQ 2005-2006 për katër KNQ në Kosovë

A. TARIFAT PËR KONSUMATORËT JO TË NJEHSUAR

KOMPANITË NQ	Komponentet e Tarifave	Residential per m2 per month	Comm.& Inst. per m2 per month
TERMOKOS	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	€ 0,17	€ 0,20
	Heat Delivered (variable comp.)	€ 0,63	€ 0,76
NQ GJAKOVA	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	€ 0,23	€ 0,30
	Heat Delivered (variable comp.)	€ 0,62	€ 0,96
TERMOMIT	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	NA	€ 0,25
	Heat Delivered (variable comp.)	NA	€ 1,05
ZVECAN	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	NA	€ 0,10
	Heat Delivered (variable comp.)	NA	€ 1,13

B. TARIFAT PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR

KOMPANITW NQ	Komponentet e Tarifave	Njwsi matwse
TERMOKOS	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	€ 1.55 / kW
	Heat Delivered (variable comp.)	€ 36.07 / MWh
DH GJAKOVA	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	€ 2.42 / kW
	Heat Delivered (variable comp.)	€ 45.97 / MWh
TERMOMIT	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	NA
	Heat Delivered (variable comp.)	NA
ZVECAN	Heat Capacity Contracted (fixed comp.)	NA
	Heat Delivered (variable comp.)	NA

Duhet të përmendet se disa çështje kryesore ishin objekt diskutimi dhe debati me NNQ:

- Subvencionimi për mazut: ZRRE i është qasur kësaj duke theksuar se ky subvencion duhet të zbritet nga kostoja reale e kompanisë.
- Çmimi i lartë i parashikuar i blerjes së mazutit i propozuar nga NNQ ishte i diskutueshëm për ZRRE-në, duke marrë parasysh çmimin e ulët të mazutit në treg.
- Përcaktimi i justifikuar i Bazës së Rregulluar të Aseteve (BRrA) për shkak të informatës kontabilitetit të pasiguritë rreth vlerës kontabël të asetëve, revaluimit të asetëve, dhe asetëve siguruar nga donacionet (ndihmat).

8.4 VAZHDIMI I IMPLEMENTIMIT TË TARIFAVE PËR NGROHJEN QENDRORE PËR SEZONIN 2005/2006

Përfundimi i shqyrtimit të çmimeve për sezonin e ngrohjes 2005/2006 është përcjellë dhe menjëherë nga ZRRE-ja, duke u dërguar palëve me interes një letër lidhur me “Reagimin mbi shqyrtimin e çmimeve të ZRRE-së për sezonin e ngrohjes qendrore 2005/2006 për NNQ Termokos dhe NNQ Gjakova dhe përmirësimet e sugjeruara”. Në letër janë konstatuar vështirësitë me të cilat ZRRE është ballafaquar gjatë shqyrtimit të çmimeve dhe masave të sugjeruara për përmirësimet. Për qëllime të koordinimit të përpjekjeve dhe masave që do të merren në të ardhmen, ZRRE organizoi një takim për të diskutuar letrën e lartpërmendur me përfaqësuesit zyrtarë të MEM-it dhe AKM-së. Pjesëmarrësit u pajtuan që të ndërmarrin veprimet e nevojshme në të ardhmen dhe masat brenda fushës përkatëse të organizatave të tyre.

ZRRE më tej monitoron ngushtë implementimin e tarifave, duke mbajtur takime dhe kontaktuar rregullisht NNQ-të. Ky bashkëveprim me NNQ përfshin kërkesën për reagim në atë se si është

përbushur faturimi, mbledhja e pagesave të konsumatorëve, ndikimi I tarifave në mbledhje, dhe numri i konsumatorëve të faturuar me “tarifë normative” dhe me “tarifë për konsumimin e energjisë”.

ZRRE vazhdimisht inkurajon NNQ-të që të kalojnë nga “tarifa normative” në “tarifë për konsumimin e energjisë” sa më shumë që të jetë e mundur duke theksuar disa fakte: “tarifa e konsumimit të energjisë” bazuar në konsumimin e matur realisht është në favor të nxitjes së konsumatorëve që të ruajnë energjinë në pajtim me nevojat e tyre; të qenit fer në faturim – psh., konsumatori është i ngarkuar me energjinë cila realisht është konsumuar – e cila mund të ngrisë shkallën e arkëtimit; dhe në fund implementimi “tarifës së konsumimit të energjisë” do të jetë kërkesë ligjore në përputhje me Ligjin mbi Ngrohjen Qendrore, cili së shpejti do të shpallet.

KAPITULLI 9 PASQYRA FINANCIARE 2005 – PLANI I BIZNESIT –PROJEKT DOKUMENTI

9.1 PASQYRA FINANCIARE 2005

Që nga themelimi në qershor 2004, ZRRE është financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Shtylla e BE në UNMIK, dhe nga organizata donatore për të mundësuar ndërtimin e saj veprues (operacional). Gjatë vitit 2005 ZRRE nuk ka gjeneruar të hyra nga taksat e licencave. Pritet që të realizohen të ardhura nga licencat nga shtatori 2006 e tutje, që do të lejojnë ZRRE-së realisht të veprojë si trup rregullativ i pavarur financiarisht. Aspektet financiare të operimeve të ZRRE-së për vitin 2005 janë pra ende të prezantuara me një Pasqyrë Burimesh dhe Aplikim i Fondeve siç u përmend në tabelën 9.1.

Tabela 9.1: Pasqyra e Burimeve dhe Aplikimi i Fondeve (në €)

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E KOSOVËS	Viti i plotë 2005	
	<i>Buxheti</i>	<i>Aktual</i>
BURIMET E FONDEVE		
Pagesat e licencave dhe lejeve	-	-
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK)	273,000	215,428
UNMIK (Shtylla e UE)	NA	240,956
Organizatat e donatorëve		
SHTYLLA E UE	55,000	64,500
AER	800,000	733,333
SIDA	158,463	188,171
USAID	-	175,000
Gjithsej nga Organizatat e Donatorëve	1,013,463	1,161,004
GJITHSEJ BURIMET E FONDEVE	1,286,463	1,617,388
SHFRYTËZIMI I FONDEVE		
Shpenzimet e Stafit		
UNMIK (Shtylla e UE)	NA	121,468
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	89,445	44,890
Gjithsej Shpenzimet e Stafit	89,445	166,358
Mallra dhe shërbime		
UNMIK (Shtylla e UE)	NA	119,488
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	153,555	142,545
Organizatrat e donatorëve	-	-
Gjithsej Mallra dhe shërbime	153,555	262,033
Asistencë Teknike nga Donatorët		
Shtylla e UE	55,000	64,500
AER	800,000	733,333
SIDA	158,463	188,171
USAID	-	175,000
Gjithsej Asistencë Teknike	1,013,463	1,161,004
Shpenzimet Kapitale		
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	30,000	27,993
Gjithsej Shpenzimet Kapitale	30,000	27,993
GJITHSEJ SHFRYTEZIMI I FONDEVE	1,286,463	1,617,388

ND: Nuk janë në dispozicion

Kostoja aktuale totale për veprimin e ZRRE-së në vitin 2005 llogaritet €1,617,388 dhe është harxhuar si vijon:

	<u>Shuma</u>	<u>Përqindja e kostove totale</u>
Shpenzimet e stafit (<i>përfshijtur 2 ndërkomb.</i>)	€166,358	10%
Të mirat dhe shërbimet totale:	€262,033	16%
Ndihma teknike:	€1,161,004	72%
Shpenzimet kapitale totale:	€27,993	2%

Gjatë vitit 2005 ZRRE është financuar nga BKK, Shtylla e BE brenda UNMIK-ut dhe nga Organizatat Donatore, si përshkruhet detajisht më poshtë.

a. **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK)**

Gjatë vitit 2005, ZRRE ka shpenzuar €215,428 aktualisht kundrejt buxhetit të lejuar të BKK prej €273,000 e i cili është zbërthyer kështu:

	<u>Buxheti i BKK</u>	<u>Aktual</u>
• Rrogat dhe Pagesat	€89,445	€44,890
• Të mirat dhe Shërbimet përfshirë shpenzimet e komunales	€153,555	€142,545
• Shpenzimet kapitale	€30,000	€27,993

Me kërkesë të Zyrës së Këshillit Fiskal në nëntor 2005, një shumë prej €30,099 ishte transferuar nga Zyra e Rregullatorit të Hekurudhave (ZRRH) në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për të mundësuar kryerjen e detyrave kundrejt kompanisë konsultative Enviros (Zyra Energjetike e benificioneve). Prandaj buxheti ZRRE-së u ngrit prej €30,099 në €303,099 për t'i mundësuar ZRRE që të paguajë këtë shumë Enviros-it.

Pjesa kryesore e mjeteve të pashpenzuara nga buxheti I BKK për vitin 2005 ishte nga kategoritë e rrogave dhe pagesave për shkak të vonesës në emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit nga ana e Kuvendit të Kosovës (në shkurt 2006 në vend të gushtit 2005); dhe mospranimi nga ana e BKK të rritjes së koeficientit për stafin si përfshihet në buxhetin e BKK. Veç kësaj, në fund të vitit 2005 ZRRE kishte 13 anëtarë me BKK, përderisa buxheti u realizua për 15 anëtarë të stafit. Shpenzimet kapitale janë përdorur për blerjen e dy automjeteve për ZRRE-në.

b. **Buxheti i Shtyllës së BE në kuadër të UNMIK-ut**

Shtylla e BE nuk ka siguruar buxhet për ZRRE-në për vitin 2005. Shpenzimet e stafit dhe Të mirave dhe Shërbimeve të shpenzuara nga ZRRE-ja nga buxheti i Shtyllës së BE në vitin 2005 janë €240,956. 8 anëtarë lokalë të stafit të BE ishin të punësuar në ZRRE në fund të vitit 2005, dhe shpenzimet e rrogave ishin €121,468. Shpenzimet e dy anëtarëve ndërkombëtarë të stafit të BE janë financuar nga buxheti qendror i Shtyllës së IV të BE dhe nuk janë të përfshira në kostot aktuale të ZRRE-së për vitin 2005. Kostoja aktuale e të Mirave dhe Shërbimeve për vitin 2005 numëron €119,488 dhe konsiston në Udhëtimet Zyrtare: €27,520; Shërbimet e rojeve të sigurimit: €16,149; Qiraja e Zyrës: €57,701; Borxhet për telefon fiks: €7,838; borxhet për telefon mobil: €2,239; dhe komunalet: €8,041.

c. **Buxheti nga organizatat donatore**

Ndihma teknike nga Donatorët në vitin 2005 kapte shumën €1,161,004, prej të cilave €64,500 ishin dhuruar nga Shtylla e BE, me €733,333 nga AER, me €188,171 nga SIDA dhe €175,000 nga USAID. Shërbimet këshilluese dhuruar nga Shtylla e BE zgjatën prej janarit deri në maj të vitit 2005 me kosto aktuale prej €64,500 krahasuar me buxhetin prej €55,000, dhe konsistuar në lidhje me punën rreth draftit mbi Rregullën mbi Procedurat për Zgjidhjen e Kontesteve, Kushteve të Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, Pasqyrës së Taksave, dhe elementeve kyçe të Metodologjisë së Tarifave.

Projekti i ndihmës teknike nga AER-i ka të bëjë me "Mbështetjen e Ndërtimit Institucional për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë", i cili filloi në fillim të vitit 2005 dhe për të cilin janë alokuar €733,333, përderisa për vitin 2006 janë alokuar €266,667.

Projekti i SIDA-s përfundoi në nëntor 2005 dhe kostoja aktuale për vitin 2005 ishte €188,171 krahasuar me buxhetin prej €158,463. Arsye për rritje aktuale prej €29,708 kundrejt buxhetit ishte sepse një pjesë e fondeve të pashfrytëzuara në vitin 2004 janë bartur në vitin 2005; dhe për arsye të financimit të rastësishëm të udhëtimit zyrtar studiues për menaxherët e ZRRE-së lidhur me Ngrohjen Qendrore në Malmö të Suedisë, në fillim të muajit nëntor 2005.

Në shtator 2005 një kontratë këshilluese financuar nga USAID filloi për pasqyrimin e shërbimeve këshilluese për ZRRE-në, e cila do të zgjasë 10 muaj. Shuma totale e kontratës është \$700,000 (€583,333) prej të cilave €175,000 janë alokuar për vitin 2005 dhe €408,333 për vitin 2006.

Stafi i ZRRE-së

Në fund të vitit 2005 ZRRE kishte 24 anëtarë të stafit: 13 me BKK, 10 me buxhet të Shtyllës së BE prej të cilëve 2 ndërkombëtarë dhe 1 staf i dytë të financuar nga USAID-i. Akoma ekzistojnë edhe katër vende të lira për t'u plotësuar: Udhëheqësi i Administratës (Shtylla e BE) dhe tre anëtarë me buxhet të BKK: një përkthyes në gjuhën serbe, një pastrues dhe mirëmbajtës dhe një ekonomist. Referuar funksionimit të stafit dhe efektivitetit të tij, ZRRE është plotësisht e bindëse dhe funksionale. Zyrtari i zotimeve, Zyrtari i Aprovimeve, Zyrtari i Certifikimeve, Zyrtari i Autorizimeve dhe Zyrtari i Certifikuar i Prokurimit janë zgjedhur nga anëtarët e stafit të ZRRE-së. Vetëm Zyrtari i Autorizimeve është anëtar ndërkombëtar i stafit (Kryesuesi i ZRRE) dhe pozitat tjera janë të plotësuara me anëtarë lokalë të stafit. Të gjithë anëtarët e stafit që realizojnë aktivitetet e përmendura më lart janë të trajnuar dhe veç I kanë treguar aftësitë e tyre në përmbushjen e këtyre funksioneve.

Përkrahja

Pritet që nga shtatori 2006 ZRRE të pranojë taksat nga licencat e nxjerra për ndërmarrjet energjetike, që reflektohet në Planin e Biznesit 2005-2009. Buxheti i BKK për vitin 2006 është reduktuar katër herë. Megjithatë ZRRE kërkoi nga BKK për tërë vitin 2006 një buxhet prej €391,468 që të veprojë në mënyrë efikase, ai ishte reduktuar herën e parë në €273,000. U reduktua pastaj për herë të dytë në €239,445 në pajtim me limitet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF). Më 18 tetor 2005 është reduktuar ky buxhet për herë të tretë në €226,463, i cili ishte nën limitet e MEF. Në janar 2006 befasisht është shkurtuar për herë të katërt në €19,017 për të rritur Pagesat dhe Rrogat për Zyrën e Auditorit Gjeneral, me të cilën buxheti i BKK për ZRRE-në për vitin 2006 ishte zbritur në €207,446, e që është afërsisht gjysma e shumës që ZRRE ka nevojë. S'ka nevojë të thuhet se ky shkurtim i madh i buxhetit rrezikon funksionimin e mirë të ZRRE-së, posaçërisht pas Shtylla e BE në vitin 2006 nuk paguan qiranë për ndërtesën e re dhe faturat e telefonit dhe paguan vetëm faturat tjera të komunales deri në qershor 2006. Në vitin 2006 nuk ka mjaft buxhet nga BKK për trajnime të stafit lokal dhe për të siguruar trajnime minimale, ZRRE është plotësisht e varur nga përkrahja e donatorëve. Mënyra e vetme për të dalë nga kjo situatë krizë është të financojmë kostot operationale të ZRRE-së me të ardhurat nga taksat e licencave, me shpresë në shtator 2006, e cila do t'i japë pavarësi financiare ZRRE-së.

9.2 PLANI I BIZNESIT

Bordi i ZRRE më 16 janar 2006 ka aprovuar Planin Pesëvjeçar të Biznesit për vitet 2005-2009 i cili shfaq synimet (qëllimet), strategjitë dhe iniciativat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) gjatë këtij viti dhe katër vjetëve të ardhshëm financiarë. Në mënyrë më të veçantë plani jep konturat e misionit të ZRRE, mandatin, objektivat dhe organizimin; jep një vështrim të strukturës dhe prospektit zhvillimor në sektorin e energjisë në Kosovë; identifikon sfidat me të cilat ZRRE ballafaqohet në kuptimin e qëllimeve strategjike dhe faktorëve që mund të ndikojnë në të arriturat e tyre; specifikon projektet, rezultatet dhe kohëzgjatjen gjatë 2006 dhe vendosë strategjitë dhe iniciativat për katër vjetët vijues financiarë; definojnë burimet e kërkuara për implementimin e projekteve dhe iniciativave të planifikuara; dhe përmban projekttime të detajuara financiare për periudhën planifikuese pesë-vjeçare. Planin e Biznesit 2005-2009, është publikuar në tërësi në faqen elektronike të ZRRE-së.

Pasqyra e Financimit dhe Profitit dhe Humbjeve për vitin 2007

Planin e Biznesit është i bazuar në vet-financimin përmes taksave të licencave dhe taksave për leje nga shtatori 2006 e tutje me qëllim të financimit të një buxheti të përshtatshëm operacional të ZRRE dhe të përmbushë aktivitetet e saj në mënyrë adekuate. Në skemën 9.2 tregojmë Pasqyrën e Profitit dhe Humbjeve për vitin 2007, gjatë të cilit vit ZRRE do të mbledhë të ardhurat nga taksat e licencave për

herë të parë gjatë tërë vitit. Për shpenzimet e stafit është skema e re e rrogave për gjithë stafin e ZRRE të përfshirë, e cila është adoptuar nga Bordi I ZRRE më 16 janar 2006 dhe poashtu është publikuar në mënyrë të plotë në faqen zyrtare elektronike të ZRRE. Llogaritja e taksave të licencave është bazuar në vlerën prej €0.22 për MWh të energjisë përafërsisht të shitur nga kompanitë energjetike dhe €0.1 për MWh të qarkullimit të përafërt vjetor të ngrohjes së shitur nga KNQ. Shuma e të ardhurave nga taksat e licencave për ZRRE-në do të jetë nën shumën maksimale ekuivalente me dy përqindëshin e qarkullimit bruto të ndërmarrjeve energjetike, si është dhënë në Nenin 24.7 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë. ZRRE është organizatë joprotabile dhe synon të realizojë të ardhura për të mbuluar shpenzimet e veta operacionale në mënyrë adekuate.

Tabela 9.2 Profiti & Humbjet e vitit 2007 sipas Planit të Biznesit

Llogaria e Fitimit dhe Humbjes	Në Euro	Si % e Të hyrave
Të hyrat (nga Licencat)	1,102,582	100.00%
Stafi	329,824	29.90%
Mallra dhe Shërbime	222,847	20.20%
Asistenca Teknike dhe Trajnime	550,000	49.90%
Zhvleftësimi	14,000	1.30%
Gjithsej Shpenzimet Operativ	1,116,671	101.30%
Humbja	-14,089	-1.30%

Nga viti 2007 e tutje është supozuar se Ndhima Teknike dhe Trajnimi do të financohen nga të Ardhurat që vijnë nga Taksat për Licenca, dhe nuk do të jepen më donacione për ZRRE-në. Humbjet e planifikuara prej €14,089 do të financohen nga Profiti gjatë vitit 2006, derisa të Ardhurat nga Licencat dhe Taksat për Leje janë planifikuar të fillojnë në shtator 2006.

9.3 PROJEKT DOKUMENTI

Në përputhje me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, “Projekt dokumenti” është një dokument i nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji i cili jep plan-projektet e propozuara për një vit kalendarik.

Projekt dokumenti, i cili aktualisht është Ndhima Teknike nga Donatorët, është ndarë më poshtë në dy kategori: në Projektet në vazhdim që vijojnë nga vitit 2005 deri në vitin 2006; dhe Projektet e ardhshme që do të fillojnë në vitin 2006.

9.3.1 PROJEKTET NË VAZHDIM

AER – PËRKRAHJA NË NDËRTIMIN INSTITUCIONAL TË ZRRE

Qëllimi i këtij Projekti është forcimi i kapaciteteve institucionale të ZRRE-së në zhvillimin e një strukture rregullative të shëndoshë, e nevojshme për të ndihmuar procesin të operimeve të tregut brenda Komitetit të Energjisë në Evropën Juglindore.

Ky projekt mbulon:

- Aktivitetet për themelimin operacional të ZRRE: procedurat për mirëmbajtjen e ndihmës në Regjistrat Publikë në definimin e masave dhe gjobave administrative të detyrueshme, të caktuara në sistemin e brendshëm të kontabilitetit, ndihmë për ZRRE në përgatitjen e projekt dokumentit dhe raportit financiar vjetor.

- Zhvillimin e Modelit të Tregut dhe Rregulloreve të Tregut: zhvillimin e një strukture complete për implementimin Modeli të Tregut me Shumicë, i cili do të jetë në pajtim me ligjet e Kosovës, direktivat e BE dhe Marrëveshjen e ECSEE.
- Rregullorja e çmimit dhe caktimit të çmimeve: përgatitja e Rregullores mbi Çmimet dhe Tarifat, zhvillimi i metodologjisë së tarifave, plani implementues dhe ndihma për ZRRE-në në Rishikimin e çmimeve.
- Licencat: zhvillimi i kërkesave për të dhëna nga të licencuarit dhe ndihma në nxjerrjen e licencave për bizneset e reja/ndërmarrjet energjetike.
- Ndihma ZRRE-së në nxjerrjen e Autorizimeve dhe Lejeve dhe në krijimin e një sistemi për pajtim për monitorim: krijimi dhe monitorimi i rregullores së kualitetit.
- Kodet Operacionale/Teknike: opsionet e Kodeve, përmbajtjen e Kodeve dhe shqyrtimin rregullativ dhe aprovimi i Kodeve Teknike.
- Trajnimi: realizon vlerësimin e nevojave për trajnim të ZRRE-së me qëllim të zhvillimit të një programi trajnues në pajtim me nevojat e ZRRE-së dhe mbajtja e trajnimit.

Fushëveprimi i projektit përmban krejt njëzetekatër nëndetyra. Statusi i këtyre nëndetyrave në fund të vitit 2005 është si vijon:

- Shtatëmbëdhjetë nëndetyra janë plotësuar, duke pritur aprovimin final apo janë pritur të plotësohen gjatë periudhës vijuese.
- Një nëndetyrë (trajnim) pritet të plotësohet në fillim të vitit 2006, përveç planit për udhëtimin studiues në Rumani, caktuar në fillim të prillit 2006.
- Gjashtë nëndetyra pritet që më vonë të plotësohen para kalimit të afatit të parë të datës 15 shkurt 2006.
- Gjatë periudhës raportuese këshilltari ka mundur të ofrojë ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnim për ZRRE-në. Intervenimet kanë përfshirë punën jo direkt lidhur me detyrat specifike të përfshira në fushën e projektit, por esenciale për t'u ndeshur me nevojat e tanishme këshilluese të ZRRE-së.

Vërejtje: Pasi ka vonesa në implementimin e Programit Trajnues dhe në Detyrat 2 dhe 3, Projekti do të vazhdohet edhe tre muaj deri kah mesi i majit 2006.

USAID – ZHVILLIMI LEGJISLACIONIT SEKONNDAR

Ky projekt jep Ndihmë Teknike për ZRRE-në në zhvillimin e legjislacionit Sekondar dhe përmban si vijon:

- Ndihmën në rishikimin dhe komentimin e draft statutit të ZRRE-së, Kodit të Etikës dhe Sjelljes, Rregullës mbi Çkyqjet dhe Rikyçjet, dhe Rregullës mbi Licencat.
- Rishikimin final dhe komentet për Rregullën mbi Kontestete dhe Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike.
- Përgatitjen e Udhëzuesit të Veprimeve dhe Rregullës mbi Fshtësinë e Informatës.
- Ekspert këshilltar përkrahës i Bordit të ZRRE-së dhe stafit kyç të ZRRE-së.
- Përkrahje ligjore për Rregullën mbi Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja të Gjenerimit, dhe për licencimin, me theks të veçantë në rehabilitimin e njësisve prodhuese të Kosovës A.

Vërejtje: Ndihma në rishikim dhe finalizim të Rregullës mbi Autorizimin, ndihma në përgatitjen e Udhëzuesit të Operimeve, Rregullës mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike – të gjitha draftet janë finalizuar dhe në pritje për procesin e konsultimit publik në tremujorin e parë të vitit 2006. Procesi është duke shkuar mirë dhe në pajtim me Termat e Referencës (TOR) fillestare. TeR të reja janë aprovuar për zgjatjen e projektit në vitin 2006 sipas nevojave të ZRRE-së.

AER – PROJEKTET PËRKRAHËSE TË GJENERIMIT

- Raport i detyrës për studimin ekonomik dhe teknik të realizueshmërisë në Rehabilitimin e Njësive të Kosovës, Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER), shtator 2005.
- Studimi i para-fizibilitetit për termocentralin e ri të bazuar në djegien e linjitet dhe masat për zbutjen e ndotjes për TC Kosova B, kontrata nr. 04KOS01/03/09/, AER, Shkurt, 2006.
- AER financon projektin “Përkrahja e mëtejme Institucionale për Zyrën e Rregullatorit për Energji në Kosovë” 05KOS01/04/001 me objektiva të veçanta: ndihmë ZRRE-së për analizimin dhe evoluimin e propozimeve për investime për elektranat e reja bazuar në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë dhe në rishikimin/aprovimin e Kodeve Teknike/ Operacionale.

9.3.2 PROJEKTET E ARDHSHME

BANKA BOTËRORE - ESTAP III

Ky projekt është financuar nga BB. Për një pjesë ZRRE ka rol monitorues dhe për të dytën ZRRE është përfitues.

Aktivitetet të lidhura me këtë projekt janë:

- Kontrata 1: OST: vazhdimësia në zhvillimin e Kodit të Rrjetit të OST dhe përgatitja e strukturës politike për rolin e Sistemit të Pavarur të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut (ITSMO).
- Kontrata 2: Korniza Tarifore: zhvillimi i Tarifave të Transmisionit dhe Tarifave për konsumatorët e fundit përfshirë edhe tarifën sociale. Ky projekt do të fillojë më 1 prill 2006 dhe do të zgjasë 8 muaj.

AER – FORCIMI I MËTEJME I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË ZRRE-SË

Ky projekt do të fillojë në mes të marsit 2006 me kohëzgjatje prej 18 muajsh. Objektivat e përgjithshme të këtij Projekti janë forcimi i kapaciteteve institucionale të Zyrës së Rregullatorit për Energji në implementimin e rregullës së strukturës rregullative, e nevojshme për të krijuar bazat për transparencë dhe operim jo diskriminues në treg, dhe të kryejë obligimet e Marrëveshjes ECSEE. Objektivat specifike janë:

- Ndihma ZRRE-së në analizën dhe evaluimin e propozimeve investuese për elektranat e reja bazuar në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë dhe rishikimin/aprovimin e Kodeve Teknike/Operacionale.
- Asiston ZRRE-në në rishikimin e çmimeve për gjenerimin, transmetim shpërndarjen, dhe furnizimin me energji, në përputhje me metodologjitë për caktimin e çmimeve dhe tarifave të nxjerra nga ZRRE-ja, duke marrë parasysh profilin e përdoruesit të fundit kur të jetë e aplikueshme (gjinia dhe etniciteti).
- Dizajni dhe Specifikimet për sistemin përkrahës për TI.
- Paraqet Procedurat e Kualitetit të Menaxhmentit në ZRRE.
- Trajton stafin e ZRRE në rishikimin rregullativ të procedurave, licencave dhe monitorimit të tregut, analizën dhe monitorimin e furnizimit me energji, dizajnimin e tregut dhe monitorimin, mbrojtjen e konsumatorëve dhe zgjidhjen e kontesteve, kontrollin e kostos/çmimit dhe tarifave, dhe gjithë aktivitetet tjera në përputhje me Termat e Referencave të stafit individual (Përshkrimet e Detyrave).

Takimi i parë për këtë projekt të dytë të ARE-it do të mbahet në fillim të prillit 2006.

AER – KRIJIMI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT DHE OPERATORIT TË TREGUT

Ky Projekt i Ndihmës teknike është financuar nga AER-I dhe është për të mirën e sektorit të energjisë në kontekst të çthurjes të sektorit të energjisë. Objektiv i përgjithshëm i këtij projekti është të përkrahë ristrukturimin e sistemit energjetik kosovar në vijë me Memorandumin e Athinës dhe Marrëveshjen ECSEE, përmes krijimit dhe zhvillimit institucional të ITSMO.

Objektivat specifike të kësaj kontrate janë:

- Ndihma në kompletimin e çthurjes së KEK-ut dhe në fillimin e operimit të ITSMO-s.

- Asistim në dizajnimin e proceseve operacionale të tregut, rregullave operacionale dhe procedurave.
- Mban trajnime për stafin operacional të OTSMO, duke siguruar barazi gjinore dhe minoritare midis stafit të trajnuar.

Rezultatet që duhet të arrihen në këtë Projekt janë:

- Programet Investuese dhe Zhvillimore dhe Plani i Biznesit janë përgatitur.
- Proceset dhe rregullat e operimit të tregut janë përgatitur.
- ITSMO është operacional dhe funksional.
- Stafit menaxhues dhe operativ janë trajnuar, duke siguruar që gratë dhe minoritetet janë përfaqësuar në mesin e stafit të trajnuar.